# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5484
E enjte, 24 maj 2018
çmimi 0.40 €



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


## Një BE e zgjeruar që përfshin Ballkanin Perëndimor në tërësi

FAQE 11



Hashim THAÇI


AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", ALI LAJÇI FAQE 4-5

# Kuvendi ka degraduar



Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi, është shprehur i pakënaqur me punën e Kuvendit të Kosovës. Ai ka thënë se Kuvendi ka degraduar dhe më nuk e ka kuptimin e vet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Lajçi ka theksuar se Kuvendi nuk mund ta përmbushë agjendën legjislative. Ai ka vlerësuar se Kosova aktualisht po përballet me një qeverisje të dobët e cila po përcillet me skandale dhe me vendime të dëmshme. Lajçi ka deklaruar se Vetëvendosja, me mbajtjen e tryezës së radhës, synon ta definojë seriozitetin për rënien e Qeverisë ose ndërprerjen e këtyre tryezave. Sipas tij, mbajtja e tryezave pa efekt është një përpjekje boshe që ia zgjat jetën pushtetit



## Haradinaj i kërkon Papa Françeskut njohjen e Kosovës

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë vizitës dyditore në Selinë e Shenjtë, është takuar edhe me Papa Françeskun, të cilit i ka shprehur përkushtimin e Kosovës për të vendosur marrëdhënie të përhershme dhe strategjike me Vatikanin. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj i ka përcjellë Atit të Shenjtë një dhuratë nga populli i Kosovës, një letër kërkesë për pranimin, njohjen dhe për kujdesin ndaj Kosovës FAQE 2

## EULEX-i transformohet në mision këshillëdhënës

FAQE 3

Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës janë të sigurt se pas 14 qershorit EULEX-i do të ketë vetëm rol këshillëdhënës. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se grupi këshillëdhënës ndërkombëtar që do të mbetet nga EULEX-i do të ketë një emër tjetër dhe ai do të vendoset nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian




## AKTUALE

PËRZGJEDHJA E DREJTORËVE NË SPITALE 'PËRPLAS' MINISTRIN ME DY KRYETARË KOMUNASH F. 6

LDK-ja KËRKON DEBAT PARLAMENTAR PËR PREMTIMET E KOALICIONIT PAN F. 7

PROCEDOHET NË KUVEND PROJEKTLIGJI PËR KOMPLEKSIN MEMORIAL "ADEM JASHARI" F. 6

## EKONOMI

KMDLNJ-ja KËRKON TË HETOHET AEROPORTI I PRISHTINËS DHE BECHTEL-ENKA F. 9

DOGANA E KOSOVËS, PARTNERE E MADHE E KOMUNITETIT BIZNESOR F. 8

## SPORT

FERIZAJ KËRKON RIKTHIMIN, VËLLAZNIMI QËNDRIMIN NË SUPERLIGË F. 18

FLAMURTARI MBETET NË SUPERLIGË F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Haradinaj i kërkon Papa Françeskut njohjen e Kosovës

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë vizitës dyditore në Selinë e Shenjtë, është takuar edhe me Papa Françeskun, të cilit i ka shprehur përkushtimin e Kosovës për të vendosur marrëdhënie të përhershme dhe strategjike me Vatikanin. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj i ka përcjellë Atit të Shenjtë një dhuratë nga populli i Kosovës, një letër kërkesë për pranimin, njohjen dhe për kujdesin ndaj Kosovës



Vatikan, 23 maj (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë vizitës dyditore në Vatikan është pritur në audiencën e mbyllur nga Ati i Shenjtë, Papa Françesku. Gjatë takimit kryeministri Haradinaj e njoftoi Atin e Shenjtë për zhvillimet politike në Kosovë, për rrugën evropiane dhe euroatlantike, duke theksuar faktin se Kosova është shembull për bashkëjetesën mes popujve dhe tolerancën fetare. "Kosova është shembull i tolerancës fetare dhe i promovimit të paqes. Rruga jonë euroatlantike fuqizohet me partneritetin strategjik me Vatikanin. Shenjtërisë së tij, Papa Françeskut, i shpreha përkushtimin e qytetarëve tanë, që vlerat shpirtërore dhe demokratike t'i ruajmë e kultivojmë, në frymën e për të mirën e përbashkët", ka thënë kryeministri Haradinaj.
Haradinaj ka vlerësuar pritjen që iu bë nga Papa Françeku, duke thënë se Kosova dhe populli i saj do t'i jenë përjetë mirënjohës Vatikanit për mbështetjen e dhënë në dekadat e fundit, po ashtu shprehu përkushtimin e shtetit të Kosovës për një partneritet strategjik me Vatikanin. "Vizita ime në Vatikan dhe takimi me Papa Françeskun është nder i madh për mua dhe popullin e Kosovës. E shfrytëzova këtë nder për t'i përcjell përshëndetjet dhe dëshirat më të mira të popullit të Kosovës për Atin e Shenjtë, Papa Françeskun, për Selinë e Shenjtë, pra për Vatikanin dhe dëshirën për të vendosur marrëdhënie të përhershme dhe strategjike", ka thënë Haradinaj. Me këtë rast kryeministri Haradinaj i ka përcjellë Atit të Shenjtë një dhuratë nga populli i Kosovës, një letër - kërkesë, për pranimin, njohjen dhe për kujdesin ndaj Kosovës. "Më bëri përshtypje se Ati i Shenjtë, Papa Françesku, ishte vërtet njerëzor, me ngrohtësi të jashtëzakonshme. Tha se 'E kam në zemër popullin e Kosovës'", ka theksuar kryeministri Haradinaj.
Duke vlerësuar lart pritjen që i është bërë në Vatikan, kryeministri Haradinaj theksoi se trajtimi dhe pritja me aq respekt është dëshmi për thellimin e raporteve ndërmjet dy vendeve. "Ai e dha bekimin për Kosovën, një bekim që ishte prekës jo vetëm për mua, por për të gjithë ne, një ndjenjë e veçantë. U ndjeva i nderuar dhe vërtet jam ndjerë i respektuar sot", ka deklaruar Haradinaj.
Kryeministri Haradinaj u shpreh i lumtur dhe mirënjohës që Kosova ka ndërtuar marrëdhënie miqësore me Selinë e Shenjtë. "Ne e kemi me shumë rëndësi këtë marrëdhënie. Vatikani, po ashtu, Selia e Shenjtë është anëtare në shumë organizata ndërkombëtare, sikurse e Interpolit dhe organizatat e tjera. Jam thellë i bindur që në rrugëtimin tonë si Kosovë do të na ndjenë. Jam i bindur se Selia e Shenjtë do ta ndjejë Kosovën", ka thënë kryeministri Haradinaj.
Takimi me Papa Francesku u bë në rezidencën e Atit të Shenjtë, në Vatikan, në audiencë të mbyllur, në kuadër të vizitës zyrtare të kryeministrit Haradinaj në Vatikan, e cila ka për qëllim vendosjen e bashkëpunimit strategjik dhe njohjen e shtetësisë së Kosovës nga Selia e Shenjtë.

LAJME SHKURT

## Protesta e opozitës, zyrtari i lartë amerikan vjen në Tiranë të njëjtën ditë



Tiranë, 23 maj - Zëvendësndihmëssekretari i Shtetit, Pete Marocco, do të jetë të shtunën në Tiranë. Pete Marocco viziton Shqipërinë në takimin e 15-të të Evropës Juglindore që mbahet në Tiranë për sigurinë rajonale dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në takim do të marrin pjesë edhe liderët e Ballkanit Perëndimor. Vizita vjen në një kohë kur të shtunën opozita ka thirrur në protestë shqiptarët.
Në njoftimin e Departamentit Amerikan të Shtetit theksohet se vizita e zyrtarit të DASh-it ka të bëjë me luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. "Zëvendësndihmëssekretari i Shtetit, Marocco, do të marrë pjesë në takimin e 15-të të Evropës Juglindore në Tiranë, dhe do të takohet me krerët e Ballkanit Perëndimor për sigurinë rajonale dhe kundërvënien e ekstremizmit të dhunshëm. Gjatë vizitës së tij në Shtutgart ai do të ketë konsultime në bazat ushtarake të EUCOM dhe AFRICOM", thuhet në njoftimin e DASH-it.

## LSI: Të shtunën rrëzojmë kryeministrin dhe Qeverinë




Tiranë, 23 maj - Kur na ndajnë edhe dy ditë nga protesta e madhe e opozitës para kryeministrisë, partia që e ka marrë më seriozisht këtë tubim duket se është Lëvizja Socialiste për Integrim.
Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, mblodhi drejtuesit e kësaj force politike në gjithë vendin, ku kërkoi një angazhim maksimal të anëtarësisë për pjesëmarrjen në mitingun e 26 majit. Në mesazhet e saj, kryetarja e LSI-së u shpreh se e shtuna është dita për t'i treguar Edi Ramës se fundi i tij është afër. Për kryetaren e LSI-së problemi i keqqeverisjes së Rilindjes nuk është një emër apo një institucion, por gjithë modeli i krimit që Edi Rama ka instaluar në vend. Duke folur për protestën e së shtunës, kryetarja e LSI-së deklaroi se me situatën ku e ka futur vendin Edi Rama nuk ka Zot që mund ta shpëtojë. "E shtuna është dita jonë për t'i treguar Edi Ramës dhe veglave të tij se asgjë nuk e ndal popullin dhe revoltën e tij ndaj krimit. Asnjë pushtetar, prokuror apo shef policie në shërbim të Edi Ramës nuk mund ta bëjë këtë. U bëj thirrje të gjithë anëtarëve dhe simpatizantëve të LSI-së dhe qytetarëve, se sot është dita për t'u ngritur dhe për ta rrëzuar njëherë e mirë Edi Ramën. Në mitingun e ditës së shtunë LSI-ja pritet të ketë një pjesëmarrje masive të qytetarëve të cilët do ta kërkojnë largimin e Edi Ramës dhe qeverisë së tij.

## Xhaferi: Maqedonia mbështet normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi

Beograd, 23 maj - Vendi i Maqedonisë dhe Serbisë është në Bashkimin Evropian (BE). Dy vendet janë të gatshme t'i plotësojnë obligimet e veta që të bëhen pjesë e familjes evropiane. Ky ka qenë qëndrimi i përbashkët i kryeparlamentarit të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Serbisë, Talat Xhaferi dhe Maja Gojkoviq, gjatë takimit të tyre të përbashkët në Beograd.
Kryeparlamentari Xhaferi ka thënë se Maqedonia mbështet normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Maqedonia mbështet Serbinë në normalizimin e raporteve me Kosovën, që çon drejt ruajtjes së stabilitetit në rajon", ka thënë Xhaferi. Sipas kryeparlamentarit Xhaferi, me gjithë dallimet për disa çështje, kjo nuk paraqet pengesë për përparimin e dialogut dhe thellimin e bashkëpunimit rajonal dhe multilateral midis dy vendeve.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Lista Serbe nuk ndryshon qëndrim ndaj formimit të ushtrisë së Kosovës

# Lista Serbe kundër çdo përpjekje për formimin e ushtrisë së Kosovës

Lista Serbe vazhdon të jetë kundër formimit të ushtrisë së Kosovës. Zyrtarët e këtij subjekti politik kanë bërë me dije se Lista Serbe do të jetë kundër çfarëdo përpjekje të institucioneve të Kosovës që për qëllim ka transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura. Ndërsa ekspertët e sigurisë kanë ftuar Qeverinë e Kosovës që mos ta presë deri në pafundësi Listën Serbe për ta bërë ushtrinë me ndryshime kushtetuese, por ta bëjë atë përmes ligjit

EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 23 maj** - Lista Serbe nuk ka ndryshuar qëndrimin kundër formimit të ushtrisë së Kosovës. Dalibor Jevtiq, i cili mban pozitën e zëvendëskryeministrit në Qeverinë e Kosovës, ndonëse ka deklaruar daljen prej koalicionit qeverisës, ka bërë me dije se nuk do ta përkrahë asnjë lloj tentimi të Qeverisë së Kosovës për ta formuar ushtrinë e Kosovës. "Lista Serbe nuk do ta përkrahë formimin e ushtrisë së Kosovës. Ky është qëndrimi që e kemi dhënë kaherë", ka thënë Jevtiq të mërkurën gjatë vizitës së tij në Ranillug.

Ditë më parë kryeministri Ramush Haradinaj, në konferencën "Kosova e sigurt dhe e mbrojtur", para ambasadorëve të akredituar në vendin tonë, kishte deklaruar se ka ardhur koha që FSK-ja të bëhet ushtri. "Është paraparë që ndryshimet kushtetuese, fuqizimi i mandatit të FSK-së, të bëhet përmes ndryshimeve të neneve kushtetuese. Unë mendoj se argumentet për ta marrë besimin e të zgjedhurve serbë, në këtë rast të Listës Serbe, janë plotësuar, mirëpo vendimi është politik", kishte thënë Haradinaj. Madje ai kishte paralajmëruar se transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri do të ndodhë qoftë përmes ndryshimeve kushtetuese ose përmes ndryshimit të ligjit.

Kjo deklaratë është mirëpritur nga njohësit e çështjeve të sigurisë, të cilët kanë vlerësuar se Kosova duhet të lëvizë në këtë drejtim duke fuqizuar FSK-në edhe me anë të ligjit. Eksperti i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se është koha e fundit për formimin e ushtrisë meqë Kosova nuk mund të presë deri në pafundësi komunitetin serb për ta ndryshuar qëndrimin. "Që tre vjet jemi duke pritur dhe duke marrë opinione të ndryshme. Rolin më të madh për të mos formësuar Forcat e Armatosura e ka Serbia, e cila ka arritur që nëpërmjet diplomacisë dhe politikës të krijojë një opinion negativ tek disa shtete, sidomos tek ato që nuk e kanë njohur Kosovën, por edhe te disa shtete që e kanë njohur Kosovën që të deklarohen kundër formimit të Forcave të Armatosura. Është koha e fundit të formohen Forcat e Armatosura, nëse jo përmes ndryshimeve kushtetuese, atëherë përmes ligjit. Lista Serbe është derivat i politikës së Beogradit dhe nuk do t'i votojë ndryshimet kushtetuese. Prandaj, duhen ndërmarrë masat e tjera apo plani 'B' që të shkohet nëpërmjet Ligjit për FSK-në. Përmes ligjit emri i mbetet FSK-së, por do t'i ketë atributet dhe detyrat shtesë që kanë të bëjnë me çështjet ushtarake. Këtë duhet ta bëjmë patjetër", ka deklaruar Qehaja.

Edhe ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova është duke humbur kohë sa i përket formimit të ushtrisë. "Në aspektin ligjor mund të bëhet. Kushtetuta kërkon të ndryshohet emri i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura, kurse përmes ligjit nuk mund t'i ndryshohet emri FSK-së, por mund t'i jepet mandati ushtarak. Përmes ndryshimit të ligjit mund t'i ndërrohet misioni FSK-së. Pastaj, në bazë të misionit, FSK-ja mund të pajiset me armatimin që është paraparë në bazë të projektit për Forca të Armatosura. Qeveria e Kosovës duhet ta ngarkojë ministrin e FSK-së, komandantin e FSK-së dhe gjeneralë të nivelit të lartë, që të shkojnë në Bruksel për t'u sqaruar ambasadorëve të NATO-s, se transformimi i FSK-së nuk e rrezikon askënd. Pra, formimi i ushtrisë së Kosovës do të jetë në dobi të rajonit", ka deklaruar Kastrati, duke shtuar se pas ndryshimit të misionit, FSK-së i hapet rruga për anëtarësim në NATO. Por, kundër kësaj nisme kanë dalë partnerët ndërkombëtarë të Kosovës, të cilët kanë bërë me dije se FSK-ja duhet të transformohet vetëm përmes ndryshimeve.



## KMShK-ja organizon Shkollën e Etikës së Gazetarisë

**Prishtinë, 23 maj** - Të mërkurën ka filluar moduli i dytë i Shkollës së Etikës së Gazetarisë me pjesëmarrjen e studentëve të gazetarisë dhe gazetarëve të ri.

Shkolla organizohet nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMShK), me mbështetjen e Fondit të Luksemburgut, implementuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. Kjo shkollë ka për qëllim ta fuqizojë rëndësinë e etikës në gazetari si dhe t'u ofrojë studentëve dhe gazetarëve të ri njohuri rreth çështjeve të etikës dhe gazetarisë në përgjithësi. Pjesëmarrës në këtë shkollë janë studentë nga tre universitete dhe gazetarë të ri. Ky modul zgjatë tri ditë.



Flet për "Epokën e re", Ali Lajçi

# Kuvendi ka degrad

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi, është shprehur i pakënaqur me punën e Kuvendit të Kosovës. Ai ka thënë se Kuvendi ka degraduar dhe më nuk e ka kuptimin e vet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Lajçi ka theksuar se Kuvendi nuk mund ta përmbushë agjendën legjislative. Ai ka vlerësuar se Kosova aktualisht po përballet me një qeverisje të dobët e cila po përcillet me skandale dhe me vendime të dëmshme. Lajçi ka deklaruar se Vetëvendosja, me mbajtjen e tryezës së radhës, synon ta definojë seriozitetin për rënien e Qeverisë ose ndërprerjen e këtyre tryezave. Sipas tij, mbajtja e tryezave pa efekt është një përpjekje boshe që ia zgjat jetën pushtetit



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 MAJ - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi, ka thënë të mërkurën se vendi po përballet me qeverisje të dobët, e cila po përcillet me skandale dhe me vendime të dëmshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se edhe Kuvendi ka degraduar dhe më nuk e ka kuptimin e vet. Sipas Lajçit, në këtë mjedis as roli i opozitës nuk është në nivel. "Kemi funksionim të dobët të Kuvendit të Kosovës. Kuvendi ka degraduar dhe më nuk e ka kuptimin e vet. Për çdo ditë po shihet se ka mungesë të kuorumit, nuk ka udhëheqje dhe menaxhim të mirë. Jo që po e rrezikon, por nuk ka shanse që Kuvendi ta përmbushë agjendën legjislative sepse është një menaxhim i keq prej kreut e deri në fund. As roli i opozitës nuk është në nivel", është shprehur ai.

Lajçi ka thënë se Qeveria ka humbur legjitimitetin, prandaj duhet rrëzuar sa më shpejt. Megjithatë, ai ka theksuar se aktualisht opozita është e pafuqishme në këtë drejtim për faktin se asnjë parti politik nuk është e gatshme për zgjedhje të parakohshme. "Në këtë aspekt dëm të madh ka bërë ndarja e këtyre deputetëve prej Vetëvendosjes. Ata nuk janë në pozitë të favorshme për zgjedhje për shkak se nuk janë konsoliduar. Përndryshe, rrëzimi i Qeverisë është i domosdoshëm. Prandaj kjo opozitë duhet të provojë dhe ta japë frytin e vet. Po të shikohet realisht asnjë parti nuk është e gatshme për zgjedhje. Por, vazhdimi i kësaj gjendje është e pamundshme", ka theksuar Lajçi. Ai ka deklaruar se Lëvizja Vetëvendosje me mbajtjen e tryezës së radhës synon ta definojë seriozitetin për rënien e Qeverisë ose ndërprerjen e këtyre tryezave.

**"Epoka e re":** *Z. Lajçi, si e komentoni punën e Kuvendit të Kosovës gjatë kësaj legjislature?*

**Lajçi:** Kemi një qeverisje të dobët e cila po përcillet me skandale dhe me vendime të dëmshme për Kosovën. Qeveria ka humbur legjitimitetin dhe është duke vazhduar dita-ditës, prandaj duhet rrëzuar sa më shpejt. Edhe Kuvendi e ka humbur rolin e tij sepse ka degraduar. Ky koalicion qeverisës i ka të gjitha të zezat të cilat i kanë sjellë imazh të keq Kosovës. Është mëkat se çfarë ka ndodhur në Kosovë në shërbimet publike, në arsim, në shëndetësi, në drejtësi dhe kudo tjetër. Nuk kemi një shtet ligjor, sepse kjo strukturë politike ka dashur arbitraritet çdo kund në institucione për shkak se ky arbitrarizëm nuk do t'i pengonte në vjedhje dhe në korrupsion. Koha është për ndryshime të mëdha si dhe për të shkuar drejt një shteti ligjor, i cili do të krijonte zhvillim ekonomik dhe investime. Është e mundur që kjo gjendje të ndryshohet me një lloj vetëdijesimi dhe mendësi tjetër të popullit të Kosovës që kur të votojnë, ta kenë mendjen për t'i bërë ndryshimet që i duhen Kosovës.

**"Epoka e re":** *Cili do të jetë funksionimi i mëtutjeshëm i Kuvendit kur kemi parasysh se në vazhdimësi ka mungesë të kuorumit, shtyrje të seancave dhe mosmiratim të ligjeve?*

**Lajçi:** Kemi funksionim të dobët të Kuvendit të Kosovës. Kuvendi ka degraduar dhe më nuk e ka kuptimin e vet. Për çdo ditë po shihet se ka mungesë të kuorumit, nuk ka udhëheqje dhe menaxhim të mirë.

**"Epoka e re":** *Kuvendi po rrezikon përmbushjen e agjendës legjislative?*

**Lajçi:** Jo që po e rrezikon, por nuk ka shanse që Kuvendi ta përmbushë agjendën legjislative sepse është një menaxhim i keq prej kreut e deri në fund.

***"Epoka e re":*** *Në gjithë këtë situatë, si e shihni rolin e opozitës?*

**Lajçi:** As roli i opozitës nuk është në nivel. Ka gatishmëri për të bërë ndryshime, njëkohësisht kërkohet koordinim i mëtutjeshëm. Nuk ka edhe aq seriozitet, por opozita duhet të

# uar



forcohet gjithnjë e më shumë në mënyrë që ta luajë rolin e vet.

**"Epoka e re":** *Përderisa në të kaluarën Kuvendi nuk ka funksionuar, askush nuk ka mundur t'i bëjë bashkë të gjitha partitë në një tryezë, ndërsa tani kur Kuvendi është funksional partitë politike kanë filluar mbajtjen e tryezave politike. Cili është qëndrimi juaj për këto tryeza?*

**Lajçi:** Kjo duhet të përfundojë me një përpjekje për krijimin e kushteve, respektivisht të votave për mocion. Nëse janë votat atëherë nuk duhet dhënë afat Qeverisë, por nëse nuk janë votat dhe vetëm po bëhen driblime e fizkultura përmes tryezave, mbajtja e tyre nuk paraqet asgjë, përveç zgjatjes së Qeverisë.

**"Epoka e re":** *Lëvizja Vetëvendosje të premten do ta mbajë tryezën e radhës e cila ka për qëllim arritjen e një konsensusi për shkuarje në zgjedhje të parakohshme. Është i realizueshëm ky qëllim?*

**Lajçi:** Duhet të definohen gjërat nëse ka vullnet. Nëse jo, duhet të pushohet me këto tryeza, sepse nuk sjellin asgjë. Lëvizja Vetëvendosje dëshiron ta definojë çështjen ose jemi seriozë në rënien e kësaj qeverie ose të ndërpriten këto tryeza. Nëse tryezat nuk kanë efekt duhet të ndërpriten. Deri më tani tryezat nuk kanë dhënë ndonjë gjë, por kjo iniciativë është nisur dhe duhet të përfundojë. Është një përpjekje boshe dhe një fizkulturë e cila më shumë e zgjatë jetën e këtij pushteti.

**"Epoka e re":** *Ka fuqi opozita për ta rrëzuar këtë Qeveri?*

**Lajçi:** Në këtë aspekt dëm të madh ka bërë ndarja e këtyre deputetëve prej Vetëvendosjes. Ata nuk janë në pozitë të favorshme për zgjedhje për shkak se nuk janë konsoliduar. Përndryshe, rrëzimi i Qeverisë është i domosdoshëm. Prandaj, kjo opozitë duhet të provojë dhe ta japë frytin e vet.

**"Epoka e re":** *Në fakt, sa i konvenon Lëvizjes Vetëvendosje shkuarja në zgjedhje pas asaj ndarje të madhe?*

**Lajçi:** Po të shikohet realisht, asnjë parti nuk është e gatshme për zgjedhje. Por, vazhdimi i kësaj gjendje është e pamundshme. Sipas mendimit tim, duhet të bëhet një reformë e Ligjit për Zgjedhje, sepse vetëm atëherë do të mund të kishim zgjedhje të efektshme. Ky proces u zvarrit nga PDK-ja dhe LDK-ja, meqë ishte interes i tyre të mos ndodhte kjo reformë. Mirëpo, reforma zgjedhore duhet të ndodhë sa më shpejt që është e mundur dhe të shkohet në zgjedhje.

**"Epoka e re":** *Keni parasysh se shkuarja në zgjedhje gjatë kësaj periudhe mund ta dëmtojë Kosovën në procesin e liberalizimit të vizave dhe të agjendës evropiane në përgjithësi?*

**Lajçi:** Me liberalizimin e vizave është bërë një driblim i keq. Pa shtet ligjor dhe pa luftim të krimit e korrupsionit nuk hiqen vizat. Madje u kushtëzua edhe territori me liberalizimin e vizave, me ç'rast territori u humb, por viza nuk do të ketë për shkak se ka edhe kushte të tjera. Prandaj, ishte një lojë shumë e ulët politike e këtyre pushtetarëve.

**"Epoka e re":** *Z. Lajçi, si e shihni fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi?*

**Lajçi:** Ky dialog nuk prodhon rezultat. Ka qenë një driblim për t'i dhënë shans Serbisë që të përfitojë. Vazhdimi i dialogut mund të bëhet vetëm nëse Serbia e njeh pavarësinë e Kosovës dhe kemi një formulë juridike. Çdo dialog pa njohjen e pavarësisë shkon në dobi të Serbisë, prandaj fundi i këtij procesi do të duhej të ishte njohja e pavarësisë. Pa njohjen e pavarësisë çdo dialog është i kotë sepse Serbia çdo çështje e politizon.

**"Epoka e re":** *Pse vazhdimisht shprehni kundër këtij dialogu dhe arritjes së një konsensusi për këtë proces, madje në çdo mënyrë kundërshtoni që presidenti ta udhëheqë këtë dialog.*

**Lajçi:** Presidenti ka sjellë vetëm trende negative në këtë proces. Për procesin e dialogut duhet të ketë një platformë të qartë konsensuale, e cila do të duhej të miratohej nga Kuvendi. Në këtë platformë do të duhej bërë e qartë se nuk ka vazhdim të dialogut me Serbinë pa njohjen e pavarësisë së Kosovës. Dialogu i deritashëm ka qenë i dëmshëm për Kosovën. Po ashtu, duhet kundërshtuar me të gjitha mjetet politike dhe juridike krijimi i asociacionit në baza etnike, sepse qëllimi i tij është ndarja e Kosovës. Krijimi i komunave etnike është i dëmshëm, prandaj ne e patëm refuzuar decentralizimin në baza etnike, por ky proces u bartë pastaj në Partesh. Si produkt i këtij procesi ka ardhur krijimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Themelimi i këtij asociacioni nuk duhet lejuar.

# EULEX-i transformohet në mision këshillëdhënës

Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës janë të sigurt se pas 14 qershorit EULEX-i do të ketë vetëm rol këshillëdhënës. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se grupi këshillëdhënës ndërkombëtar që do të mbetet nga EULEX-i do të ketë një emër tjetër dhe ai do të vendoset nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian

**Prishtinë, 23 maj** - Nga data 14 qershor Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit, EULEX, pritet ta ndryshojë mandatin. Mandati aktual, me përgjegjësi ekzekutive, monitoruese dhe mentoruese nga fusha e sigurisë dhe drejtësisë, këtij misioni i mbaron më 14 qershor, kur pritet të kalojë në mandatin këshillëdhënës. Kështu paralajmërojnë zyrtarët e Qeverisë së Kosovës, duke u thirrur në bisedimet që janë zhvilluar me autoritetet e Bashkimit Evropian në Bruksel.

Nga misioni i EULEX-it thonë se gjithçka pritet të sqarohet ditët në vijim. Zëdhënësja e EULEX-it, Donika Berisha, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se mandati aktual i këtij misioni zgjatë deri më 14 qershor të këtij viti. Ajo ka thënë se deri pas datës 14 qershor nuk mund të thuhet asgjë se çfarë vendime do të ketë lidhur me të ardhmen e misionit. "Parashihet se misioni do t'i mbajë disa aktivitete të monitorimit, në veçanti në lidhje me lëndët gjyqësore që tashmë janë në proces të transferimit tek gjyqësori i vendit", ka thënë Berisha.

Ndërsa në Qeverinë e Kosovës tashmë janë të sigurt se EULEX-i pas 14 qershorit do të ketë vetëm rol këshillëdhënës. Përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës konsiderojnë se Kosova ka arritur t'i ndërtojë kapacitetet e veta të fuqishme për t'i marrë përgjegjësitë në sistemin e drejtësisë, përfshirë edhe fushat në të cilat deri më tash misioni i EULEX-i ka pasur rolin kryesor.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se tashmë ekzistojnë vlerësime edhe nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare në Kosovë, se mekanizmat e drejtësisë, edhe ato të sigurisë, kanë kapacitet t'i marrin mbi vete të gjitha përgjegjësitë që deri tash i ka pasur EULEX-i. "Më nuk do të kemi mision me mandat ekzekutiv në Republikën e Kosovës. Pra, do të jenë kosovarët ata, institucionet që do të jenë përgjegjës për agjencitë zbatuese të ligjit për qeverisjen e vendit dhe zbatimin e ligjit", ka thënë Tahiri.

Ministri Tahiri ka theksuar se grupi këshillëdhënës ndërkombëtar që do të mbetet nga EULEX-i do të ketë një emër tjetër dhe ai do të vendoset nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Misioni i EULEX-it është vendosur në Kosovë nga Bashkimi Evropian pak ditë para shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, për ta ndihmuar shtetin e ri në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit. Këtij misioni në vitin 2016 i ishte vazhduar mandati deri në qershor 2018. Autoritetet në Kosovë në atë kohë patën deklaruar se po punojnë që misioni ta përfundojë punën brenda afatit prej dy vjetësh.



# Përzgjedhja e drejtorëve në spitale "përplas" ministrin me dy kryetarë komunash

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 MAJ - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, dhe ai i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, në një reagim të përbashkët kanë shprehur shqetësimin e tyre për procesin e përzgjedhjes së drejtorëve të spitaleve në këto dy komuna.
Në reagimin e dy kryetarëve thuhet se Partia Demokratike e Kosovës (PDK) po synon dëmtimin e sistemit shëndetësor. "Qëllimi i PDK-së, që përmes ministrit Uran Ismaili të vendosen në krye të Spitalit të Mitrovicës dhe të Spitalit të Vushtrrisë persona që janë anëtarë të subjektit politik PDK, apo edhe familjarë të tyre, e që nuk vijnë nga fusha e shëndetësisë, tregon se kjo parti ka qëllim primar kapjen e pozitave kyçe në shëndetësi dhe përmes tyre kontrollimin dhe presionin ndaj personelit shëndetësor", thuhet në reagimin e kryetarëve.
Kryetari i Mitrovicës dhe i Vushtrrisë përmes reagimit të tyre kanë kërkuar rishikimin e konkursit për përzgjedhjen e dy drejtorëve. "Personi i vlerësuar me më së shumti pikë për Spitalin e Vushtrrisë është asamblist i PDK-së dhe ish-drejtor komunal në dy mandate. Edhe kandidatja e vlerësuar me më së shumti pikë për Spitalin në Mitrovicë është gruaja e këshilltarit politik të Kadri Veselit. U bëjmë thirrje institucioneve përgjegjëse, me theks të veçantë kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, kryetarit të Kuvendit dhe presidentit që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për ta rishikuar rastin e konkursit për përzgjedhjen e dy drejtorëve të këtyre spitaleve", thuhet në reagim.
Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, u është kundërpërgjigjur kryetarëve të komunave, duke thënë se konkursi është shpallur nga ShSKUK-ja e jo nga Ministria e Shëndetësisë. "Agim Bahtiri i AKR-së/VV-së dhe Xhafer Tahiri i LDK-së, në një reagim të përbashkët, paskan shprehur shqetësim e tyre për procesin e përzgjedhjes së drejtorëve të spitaleve në Mitrovicë dhe Vushtrri, komuna që ata drejtojnë. Bahtiri e Tahiri paskëshin kërkuar anulimin e konkurseve, me arsyetimin se po tentohet të politizohen spitalet dhe të dëmtohet sistemi shëndetësor. Është e vërtetë se ata mund të jenë të shqetësuar, mirëpo jo për qytetarët dhe as për sistemin shëndetësor, por për veten e tyre. Kur flasin për 'politizim' dhe 'dëmtim të sistemit shëndetësor', Bahtiri e



Tahiri realisht mendojnë në 'punët' që kanë bërë, e që do t'u ndërpriten në komunat e tyre. Me reformat që kemi nisur në shëndetësinë e Kosovës largohen të papërgjegjshmit që u shërbejnë klientelave dhe afrohen profesionistët që u shërbejnë qytetarëve. E di se kjo dhemb shumë, sepse për ata që kanë instaluar klientelizmin në qytetet e tyre, qoftë në spitalet rajonale, qoftë në shërbimet spitalore, prerja e rrënjëve të krimit nënkupton dobësimin e tyre dhe forcimin e qytetarëve. Vizioni i PDK-së, të cilin unë si Ministër i Shëndetësisë jam duke e shtrirë me kënaqësi të madhe dhe vullnet të fortë gjithandej institucioneve shëndetësore, është ekskluzivisht për qytetarët. Sa për konkurset, ato hapen nga ShSKUK-ja e jo nga Ministria e Shëndetësisë", ka thënë Ismaili. Ai ka shtuar se Bahtiri dhe Tahiri bëjnë mirë të mos përzihen në kompetencat e drejtorit të ShSKUK-së. "Ky është presion që bëhet për t'i ruajtur interesat e tyre. Por, i siguroj që të dy, dhe këdo tjetër, se nuk do të ketë dorëzim në luftimin e krimit dhe në qëllimin e mirë që, më në fund, të kthehet mbarë shëndetësia. E dimë të gjithë rrëfimin për shëndetësinë e udhëhequr nga LDK-ja gjatë mandatit të kaluar qeverisës. E ka shtrirë përtokë. E di se do të marrë kohë për ta çuar në këmbë. Por, punët e mira kanë nisur dhe do të vazhdojnë", ka thënë Uran Ismaili, ministër i Shëndetësisë.

# Nitaj: Po rrezikohet funksionimi i Gjykatës Kushtetuese

PRISHTINË, 23 MAJ - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka kritikuar kolegët deputetë që në seancën e fundit nuk kanë arritur t'i zgjedhin gjyqtarët e ri të Gjykatës Kushtetuese. Në profilin e vet në "Facebook" Nitaj ka shkruar se në këtë mënyrë po rrezikohet funksionimi i kësaj gjykate. "E dhimbshme që parlamenti nuk mundi t'i votojë gjyqtarët e ri të Gjykatës Kushtetuese, duke bërë kështu të rrezikohet funksionimi i kësaj Gjykate! Nuk janë votuar edhe plot borde e komisione nga të cilat do të varej funksionimi normal i shtetit e i mekanizmave të tij. Në vend të kësaj janë kërkuar katër debate për tema të ndryshme, rezultati i të cilave, edhe pas përfundimit, do të jetë 'nul'", ka shkruar Nitaj. Ai ka theksuar se nëse opozita e djeshme e kishte bërë Kuvendin e Kosovës 'gaz me gaz', kjo e sotmja po e bën gazin e botës me debate e interpelanca që jo rrallë nuk janë as në mandatin e tij.






# Procedohet në Kuvend Projektligji për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari'

PRISHTINË, 23 MAJ (ER) - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, të mërkurën ka miratuar Projektligjin për Kompleksin Memorial "Adem Jashari". Ndonëse kjo pikë nuk ka qenë në rend të ditës, deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, ka propozuar që ky projektligj të hedhet në votim.
Projektligji për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" do të procedohet në seancën e Kuvendit. Anëtarët e komisionit diskutuan edhe rreth amendamenteve të Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Projektligji, me amendamente, u përkrah dhe u procedua për shqyrtim të mëtejmë në Kuvend.



# Edita Tahiri në OKB kërkoi përfshirje më të madhe të grave në negociata paqësore

EPOKA E RE Faton DERMAKU

NJU JORK, 23 MAJ - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në bisedimet e Brukselit, Edita Tahiri, njëherësh kryetare e Lobit Rajonal të Grave të Evropës Juglindore, ka qëndruar në Nju Jork, ku ka marrë pjesë në takimin e UNWomen të OKB-së rreth fuqizimit të grave në procese paqësore dhe negociata paqësore (më 16 dhe 17 maj 2018). Në këtë takim kanë marrë pjesë tridhjetë gra eksperte nga gjithë bota, duke përfshirë gra negociatore të paqes, akademike, analiste të fushës etj.
Temë qendrore e këtij takimi dyditor ishte "Pjesëmarrja përmbajtjesore e grave për negocimin e paqes dhe zbatimin e marrëveshjeve paqësore", ku angazhimi i pjesëmarrësve u fokusua në gjetjen e rrugëve për ta avancuar pjesëmarrjen kuptimplote të grave në proceset e paqes në pajtim me kërkesat e Rezolutës 1325 (2000) të Këshillit të Sigurimit dhe rezolutave të tjera derivuese, raporton "Epoka e re". Në këtë takim, Edita Tahiri ka folur për përvojat si negociatore e paqes në periudhën e luftës dhe paqes në Kosovë, duke përfshirë pjesëmarrjen në Konferencën e Rambujesë (1999), në negociatat e vitit 1998 si parapërgatitje për Konferencën e Rambujesë si dhe për rolin si kryenegociatore e Republikës së Kosovës në dialogun e Brukselit gjatë shtatë viteve (2011-2017).
Ajo ka vlerësuar se gratë kanë potenciale për të qenë negociatore të suksesshme për paqe sepse janë të përkushtuara për paqe dhe drejtësi, duke treguar shembullin e saj, që në periudhën e pasluftës, si grua kryenegociatore kishte arritur marrëveshjen e parë në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dy shtete me një histori armiqësore ku Serbia kishte qenë jo vetëm shtet okupator, por kishte bërë një gjenocid të paparë ndaj popullit shqiptar. "Baza e çdo marrëveshje paqësore duhet të jetë drejtësia dhe ardhmëria paqësore, që siguron se historia e shtypjeve dhe luftës nuk do të përsëritet më asnjëherë", ka thënë Tahiri, duke theksuar se gratë mund të japin kontribut esencial për këto qëllime. Ajo tha se në proceset ndërkombëtare paqësore për ndaljen e luftërave në Ballkan, në kuadër të zhbërjes së ish-Jugosllavisë, fatkeqësisht kanë munguar gra në tryezat e bisedimeve, përveç vetë asaj që ka qenë e vetmja grua negociatore e paqes në gjithë Ballkanin.
Edita Tahiri ka kërkuar nga OKB-ja dhe sekretari gjeneral i saj të angazhohen për pjesëmarrjen sa më të madhe të grave në negociatat për paqe dhe procese paqësore në përgjithësi, duke qenë se shkenca dhe praktika kanë argumentuar që pjesëmarrja e grave në negociata paqësore, rrit gjasat për arritjen e marrëveshjeve paqësore, paqebërjen e paqendërtimin e qëndrueshëm. Në kuadër të këtij takimi Edita Tahiri u takua me Paivi Kannisto, udhëheqëse e Departamentit për Paqe dhe Siguri në UNWomen, me të cilën ka biseduar rreth angazhimit të grave të rajonit të Ballkanit në proceset e paqes dhe nevojën për një mbështetje sa më të madhe nga nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare, në interes të një paqe dhe sigurie të qëndrueshme si dhe për përshpejtimin e integrimeve euroatlantike.

# LDK-ja kërkon debat parlamentar për premtimet e koalicionit PAN

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 23 MAJ - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka dorëzuar të mërkurën kërkesën për debat parlamentar në lidhje me premtimet që i ka bërë koalicioni PAN gjatë fushatës së zgjedhjeve parlamentare të vitit të kaluar. Këtë e ka bërë me dije shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, përmes një statusi në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas tij, dokumenti i miratuar në Qeveri duhet t'i reflektojë premtimet e koalicionit PAN për zhvillim ekonomik prej 8-10 %. "Sot grupi parlamentar i LDK-së e dorëzon kërkesën për debat parlamentar lidhur me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021, që është aprovuar në Qeveri dhe dorëzuar në Kuvendin e Kosovës. Në parim, ky dokument duhet t'i reflektojë premtimet e koalicionit qeverisës PAN për zhvillim ekonomik prej 8-10 përqindësh, rritje të punësimit, investime në arsim e shëndetësi dhe premtime të tjera, të cilat premtime as për së afërmi nuk shihet se do të mund të realizohen. Ne do të kërkojmë përgjigje për secilën pikë të këtij dokumenti se përse nuk reflekton premtimet elektorale të koalicioni PAN", ka thënë Hoti. Ai ka shtuar se secili politikan duhet të mësohet se nuk ka më hapësirë në politikë për mashtrime. "Fraza e premtime boshe gjatë fushatës, ndërkaq kur merret qeverisja harrohen të gjitha. Ne do të kërkojmë llogari në emër të qytetarëve për secilin premtim të koalicionit PAN", ka thënë Hoti.



# OAK-u: Kuvendi votoi kundër investimeve dhe zhvillimit të vendit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 MAJ - Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) ka shprehur shqetësimin e saj për refuzimin e deputetëve për ndryshimin e projektligjit për shoqëritë tregtare, saktësisht neni 34, pika 2, duke thënë se dëmton bizneset dhe pengon sjelljen e investitorëve të huaj. "OAK-u vlerëson se me këtë nen Kuvendi i Kosovës ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kapitulli 1, neni 10, ku thuhet se ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Imponimi në gjininë e udhëheqësve në korporata dëmton rëndë biznesin, Kushtetutën e vendit dhe është një pengesë për investimet e huaja në Kosovë dhe për rritjen e punësimit. Ky votim nga ana e Kuvendit të Kosovës më tepër ngjason me vendimet e marra në vendet komuniste sesa ato kapitaliste dhe tregtisë së lirë, siç është Republika e Kosovës", thuhet në reagimin e OAK-ut. Arsyetimi i sponsoruesve për rivotim, se ligje të tilla ekzistojnë në Gjermani, Itali e shtete të tjera, sipas OAK-ut, është plotësisht i paqëndrueshëm dhe me tendencë të drejtpërdrejtë të pengimit të investimeve dhe të dëmtimit të korporatave në vend. "Në disa shtete mund të ekzistojë ndonjë rekomandim i tillë, por jo detyrim që në fillim 40 % e pas dy vjetëve 50 % e udhëheqjes së bizneseve private t'i takojnë pjesëtarëve të gjinisë së caktuar. OAK-u kërkon nga kryeministri dhe Qeveria e Kosovës të reagojë dhe ta dërgojë në Kuvendin e Kosovës propozimin për ndryshimin e këtij neni. Për dijeni të deputetëve votues të këtij neni,




si pasojë e mungesës së ligjeve, mungesës së ofertave të favorshme për investime, mosfunksionimit të gjykatave dhe klimës jo të mirë të të bërit biznes, Kosova vazhdon të mbetet shteti më i varfër në Ballkan me shkallën më të lartë të papunësisë dhe buxhetin më të vogël", thuhet më tutje në reagim.

OAK-u ka bërë me dije se do t'i përdorë të gjithë mekanizmat e mundshëm në këtë drejtim.

# Lekaj: Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të avancojë në ofrimin e shërbimeve



EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 MAJ - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka vizituar të mërkurën Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës (AACK), me ç'rast është takuar me drejtorin e përgjithshëm të AACK-së, Driton Gjonbalaj dhe stafin e AACK-së, me të cilët ka biseduar për të arriturat e kësaj agjencie, si dhe për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe AACK-së.

Ministri Lekaj ka thënë se AACK-ja duhet të avancojë në ofrimin e shërbimeve dhe marrjen e përgjegjësive shtesë që i takojnë në fushën e aviacionit civil, si dhe në avancimin e resurseve profesionale, në mënyrë që edhe aty ku ka sfida, të tejkalohen me profesionalizëm dhe në shërbim të qytetarëve. Lekaj ka treguar gatishmërinë e ministrisë që drejton, për përkrahje të parezervë kurdo që është e nevojshme dhe kurdo që kërkohet një gjë e tillë.

Ndërsa drejtori i përgjithshëm i AACK-së, Driton Gjonbalaj, duke e falënderuar ministrin Lekaj për gatishmërinë e treguar për bashkëpunim të hapur dhe funksion të harmonizimit të veprimeve mes dy autoriteteve, ka shprehur gatishmërinë e institucionit që drejton, për thellim të bashkëpunimit dhe veprimeve për anëtarësim të AACK-së në organizatat ndërkombëtare të aviacionit civil, si ai i ICAO-s, duke kërkuar edhe përkrahjen e ministrit Lekaj.

Drejtori Gjonbalaj me anë të një prezantimi e ka njoftuar ministrin Lekaj dhe bashkëpunëtorët e tij rreth detyrave dhe përgjegjësive të agjencisë, po ashtu edhe rreth objektivave që synohen të arrihen. Gjonbalaj e ka njoftuar Lekajn edhe për marrëveshjet e arritura mes tyre dhe agjencive simotra, si dhe për marrëveshjet që synohen të arrihen në të ardhmen, e që kanë ndikim pozitiv për vendin dhe qytetarët e Kosovës.

Në këtë takim u bisedua edhe për normalizimin e hapësirës ajrore, si një proces ku ka ndërhyrje politike nga fqinji ynë verior, por u tha se ky proces nuk do të ndalet deri në normalizimin e plotë të hapësirës ajrore të Kosovës, sepse ka rëndësi për shtetin dhe qytetarët e vendit si në aspektin strategjik, po ashtu edhe në atë ekonomik.

# Dogana e Kosovës, partnere e madhe e komunitetit biznesor




Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë ndër institucionet që kanë punuar për lehtësimin e të bërit biznes. Ndërkaq drejtori i përgjithshëm i Doganës, Bahri Berisha, ka thënë se gjatë këtij viti kanë ndërmarrë masa të shumta për lehtësimin e të bërit biznes në Kosovë dhe janë duke punuar për eliminimin e barrierave jotarifore

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 23 maj - Sektori privat në Kosovë vazhdimisht është ballafaquar me vështirësi në zhvillimin e bizneseve si nga aspekti doganor, po ashtu edhe në zhvillimin e mundësive për t'u qasur në tregun ndërkombëtar mirëpo, falë bashkëpunimit të vazhdueshëm mes bizneseve dhe Doganës së Kosovës, barrierat jotarifore, vështirësitë në tregun ndërkombëtar dhe problemet e tjera në ambientin biznesor kanë arritur në një nivel mjaft të ulët. Ky përfundim është nxjerrë nga tryeza e radhës e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë e titulluar "Tregtia: sfidat e sektorit privat". Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka përmendur partneritetin e vazhdueshëm mes Doganës dhe Odës, i cili ka dëshmuar të jetë i dobishëm për komunitetin biznesor në shumë aspekte. Ai ka shtuar se Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë ndër institucionet që kanë punuar në lehtësimin e të bërit biznes. Ndërsa Avni Krasniqi, kryesues i Komitetit të Tregtisë dhe Doganave të Odës Amerikane, ka thënë se problemet e shumta që në të kaluarën bizneset kanë hasur tashmë janë minimizuar përmes këtij bashkëpunimi. Ai ka thënë se roli i Doganës mbetet kyç për zhvillimin e bizneseve.

Drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ka thënë se gjatë këtij viti kanë ndërmarrë masa dhe procedura të shumta për lehtësimin e të bërit biznes në Kosovë dhe janë ende duke punuar për eliminimin e barrierave jotarifore. Ai ka shtuar se është duke u implementuar heqja e akcizës në produkte të caktuara e cila është duke i ndihmuar mjaft bizneset, duke shtuar edhe faktin e rënies së ankesave nga ana e komunitetit biznesor në raport me Doganën, çfarë tregon se partneriteti mes tyre vazhdon të mbetet në nivel.

Berisha ka përmendur edhe digjitalizimin e procedurave të shumta doganore, që ka ndihmuar për zvogëlimin e rasteve të korrupsionit. Ai ka ftuar bizneset t'i paraqesin kërkesat e tyre te Dogana, pasi një gjë e tillë do të lehtësonte zhvillimin e bizneseve të tyre në njërën anë dhe përmbushjen e detyrës së Doganës nga ana tjetër. Më tej pjesëmarrësit patën rastin t'i parashtrojnë pyetjet e tyre dhe vështirësitë që hasin në procedurat doganore, duke shtuar se do ta vazhdojnë partneritetin me Doganën në të ardhmen.

## KMDLNj-ja kërkon të hetohet Aeroporti i Prishtinës dhe Bechtel-Enka

Prishtinë, 23 maj (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar të hetohet Aeroporti i Prishtinës për rastin e shtetasve turq dhe "Bechtel-Enka" për policët e aksidentuar në lumin Lepenc. KMDLNj-ja përmes një komunikate për medie ka theksuar se Kosova kohët e fundit është përfshirë në një veprim thuajse ilegal, me ç'rast, me kërkesë të Turqisë, u bë protagonist i një shkeljeje të rëndë të të drejtave të njeriut, duke i grabitur gjashtë shtetas turq me lejeqëndrim të rregullt, sikurse edhe me leje pune në Kosovë për një kohë të gjatë.

KMDLNj-ja ka vlerësuar se tashmë, kur edhe zyrtarisht është sqaruar se një aviokompani turke, duke falsifikuar dokumentet ka siguruar një leje nga autoritetet e Kosovës për transportimin e gjashtë qytetarëve, duhet të nisin hetimet ndaj udhëheqësve të aeroportit. "Meqë bëhet fjalë për gjashtë shtetas turq, për shtetin turk, për aviokompaninë kriminale turke, për aeroportin e Prishtinës që i është dhënë në koncesion kompanisë 'Limak Calik' (nga Turqia) dhe e afërt, në mos edhe pronare e udhëheqësve të lartë të shtetit turk, atëherë nuk mjafton shqiptimi i dënimit qoftë edhe prej një milion eurosh për aviokompaninë kriminale turke, dënimin eventual të cilën e paguan vetë shteti turk dhe për këtë bashkëpjesëmarrje në këtë krim kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut do të shpërblehet shumë nga Turqia, por duhet të zhvillohen hetimet ndaj drejtuesve (turq) të aeroportit të Prishtinës dhe, në rast se sigurohen prova për përfshirjen e tyre në këtë krim dhe shkelje të rëndë të drejtave të njeriut, koncensionarit të aeroportit Limak Celik duhet t'i merret leja e punës", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Po ashtu, pas raporteve të obduksionit dhe pas hetimit të prokurorisë për vdekjen e dy policëve të Kosovës në lumin Lepenc, KMDLNj-ja ka kërkuar të shtohen hetimet kundër 'Bechtel Enkës' për përgjegjësi eventuale. "Sipas raportit të Policisë dhe Prokurorisë së Shtetit, automjeti i policëve të aksidentuar teknikisht ka qenë në rregull, kurse shpejtësia ka qenë 30-35 km/h. Realisht, në një terren ku nuk ka akull apo që është i rrëshqitshëm për shkaqe të tjera me një automjet teknikisht në rregull, frenimi nuk paraqet problem. Mospasja e sinjaleve dhe ndriçimit në rrugë ku bëhen punët dhe e cila ngushtohet e që është përgjegjësi e kompanisë që i ka kryer punët, mund të jetë shkaktar për humbje të jetës së dy policëve dhe këto, pas një hetimi, duhet të kërkohet përgjegjësia eventuale e 'Bechtel Enkës'", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së.

## DRC-ja mbështet Mitrovicën në përmirësimin e kushteve të komuniteteve

MITROVICË, 23 MAJ (ER) - Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka pritur të mërkurën menaxheren e Zyrës së DRC-së në Mitrovicë, Jasmina Dalipoviq, me të cilën ka biseduar për realizimin e projekteve të DRC-së në këtë qytet dhe thellimin e bashkëpunimit të mëtutjeshëm.

Jasmina Dalipoviq, menaxhere e projekteve të Zyrës së DRC-së, ka pohuar se DRC-ja në vazhdimësi ka një bashkëpunim të mirë me Komunën e Mitrovicës dhe se shpreson se ky bashkëpunim do të jetë i suksesshëm edhe në të ardhmen. "Aktualisht jemi duke punuar në projektin e ri për mbështetje të komunitetit ashkali, romë dhe egjiptas në Mitrovicë, për katër vjetët e ardhshëm dhe falënderojmë Komunën e Mitrovicës e cila gjithmonë ka treguar gatishmëri të jetë pjesë e projekteve të realizuara nga DRC-ja", ka thënë Dalipoviq.

Nënkryetari Mujka ka falënderuar përfaqësuesit e DRC-së për kontributin e madh që po japin në mbështetje të qytetarëve të Mitrovicës. Ai ka thënë se komuna dhe drejtuesit e saj janë të gatshëm dhe kanë vullnetin e duhur për të ndihmuar në të gjitha projektet që DRC-ja i realizon.






## Testi i maturës në rajonin e Prishtinës mbahet më 29 maj dhe 6 qershor

PRISHTINË, 23 MAJ (ER) - Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kanë organizuar takim informues me mësimdhënës lidhur me përgatitjet e organizimit të provimit Shtetëror të Maturës, si dhe për punët detyrat dhe përgjegjësitë e administruesve dhe monitoruesve që do t'i kenë në këtë proces.

Provimi Shtetëror i Maturës këtë vit do të organizohet në disa faza dhe sipas regjioneve. Në regjionin e Prishtinës do të mbahet më 29 maj dhe 6 qershor 2018.

Në këtë takim mësimdhënësit e Komunës së Prishtinës janë njoftuar se do të administrojnë dhe monitorojnë testin e maturës në Komunën e Podujevës, të Obiliqit, të Fushë-Kosovës dhe në Komunën e Drenasit.

Përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit dhe të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë kërkuan nga mësimdhënësit e angazhuar në këtë proces që, në datat e theksuara, të jenë të mobilizuar si dhe punët e detyrat e përcaktuara t'i realizojnë me përgjegjësi, kompetencë dhe profesionalizëm të lartë, në mënyrë që e gjithë ecuria e testit të rrjedhë sipas standardeve të kërkuara.

# Shkolla 'Hasan Prishtina' në Tërpezë shënon 70-vjetorin e themelimit

MALISHEVË, 23 MAJ (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të mërkurën në ceremoninë festive të 70-vjetorit të themelimit të Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët "Hasan Prishtina" në Tërpezë të Malishevës. Ministri Bytyqi ka thënë se kjo shkollë, me kaq shumë vite punë dhe me një emër të madh, vazhdimisht ka qenë vatër e edukimit të të rinjve, një vatër që ka nxjerrë kuadro që më vonë kanë kontribuar në shumë aspekte të zhvillimit. "Kjo shkollë, mësimdhënësit tanë, kanë bërë një sakrificë të jashtëzakonshme që sot të jemi këtu. Ata kanë kontribuar që shkolla sot, në këtë 70-vjetor të themelimit, të jetë krejt ndryshe, që Tërpeza sot ta festojë krejt ndryshe ditën e shkollës. Kjo na bënë krenarë, na e lehtëson punën dhe na shton përgjegjësinë për të vazhduar më tutje", ka thënë ministri Bytyqi në shkollën ku edhe ai vetë i ka vijuar mësimet si nxënës.






## Në Rahovec nis dhënia e gjobave për hedhësit e mbeturinave

RAHOVEC, 23 MAJ (ER) - Që nga data 21 maj i këtij viti Drejtoria për Punë Inspektuese në Komunën e Rahovecit, përkatësisht inspektorët e kësaj drejtorie, kanë nisur dhënien e gjobave mandatore për hedhësit e mbeturinave në vende ku është e ndaluar me ligj. Sipas një njoftimi të kësaj komune, deri më tani janë shqiptuar tri gjoba.

## Mbahet punëtoria për turizmin në kryeqytet

PRISHTINË, 23 MAJ (ER) - Është mbajtur punëtoria njëditore lidhur me Strategjinë e Turizmit në Prishtinë, në të cilën kanë marrë pjesë aktorë të ndryshëm të këtij sektori. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte përbashkimi i ideve mes sektorit publik dhe atij privat, për ta vendosur Prishtinën në hartën e destinacioneve turistike. "Strategjia e Turizmit për Komunën e Prishtinës do të bazohet në metodologjinë e menaxhimit të destinacionit, me fokus për identifikimin, përcaktimin, vizatimin dhe përshkrimin e flukseve strategjike të vizitorëve brenda Komunës së Prishtinës", ka thënë kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti.



# Një BE e zgjeruar që përfshin Ballkanin Perëndimor në tërësi



Hashim THAÇI

Forumi i Tetë "To be Secure" (2BS), i cili u mbajt në Budvë të Malit të Zi, doli me tezën fillestare, se shtyllat e Bashkimit Evropian janë tronditur nga kriza ekonomike, kriza e migracionit dhe nga Brexiti. Është e rëndësishme, kur përballemi me një kontekst kaq kundërshtues, të mos e harrojmë atë që, megjithatë, po funksionon aktualisht.

Rritja e populizmit të krahut të djathtë është një tendencë në Evropë tash për tash, por nuk është e vetmja karakteristikë. Tendenca të ndryshme dhe shpesh në kundërshtim me njëra-tjetrën janë të pranishme në të njëjtën kohë. Kishte opinione që parashikuan një efekt domino të Brexitit, menjëherë pas referendumit, si moment që do të krijojë valë të fitoreve të populizmit. Por, ajo çfarë po shohim është e vërteta se BE-ja qëndron e fuqishme dhe forcat proevropiane kanë fituar në shumicën e shteteve të saj. Madje suksesi i lëvizjes "En Marche" të presidentit francez Macron vitin e kaluar, është vetëm një nga shembujt më të dallueshëm.

BE-ja, e mbështetur nga NATO-ja në sensin e sigurisë, është projekti më i madh i paqes dhe më i suksesshmi i kontinentit deri më sot. Problemi qëndron tek grupime dhe qarqe që, fatkeqësisht, BE-në nuk e shohin më si projekt paqeje.

Që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore kanë kaluar 73 vjet.

Vetëm gjenerata shumë e vjetër ka kujtime nga lufta. Por, në Ballkanin Perëndimor është ndryshe. Kujtimet e luftës dhe vuajtjet e popullit janë ende të gjalla tek të gjithë në Kosovë.

Për ne, BE-ja është shembull i paqes, pajtimit, tejkalimit të së kaluarës dhe rritjes së bashkëpunimit dhe ndërvarësisë në mënyrë graduale.

Sigurisht se BE-ja nuk është vetëm një projekt i paqes. Është një strukturë qeverisëse mbi-nacionale që vazhdimisht e zgjeron dhe thellon bashkëpunimin në të gjitha fushat politike, ekonomike etj.




Zgjerimi i BE-së nuk duhet të vihet në dyshim. Prandaj, mesazhi im kryesor në këtë forum është: tendenca në rritje e populizmit të ekstremit të djathtë nuk duhet të përdoret si justifikim për vendet anëtare të BE-së që të mos mbajnë hapur derën për Ballkanin Perëndimor. Sot BE-ja duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje trajtimit të krizave ekonomike, migracionit dhe qasjes ndaj politikave të zgjerimit.

Ne shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet ta bëjmë zbatimin e reformave të rëndësishme. Të bëjmë reforma ekonomike për t'i forcuar financat publike dhe për ta forcuar stabilitetin makroekonomik.

Ta përmirësojmë bashkëpunimin në çështjet e brendshme dhe të sigurisë për ta parandaluar migracionin e paligjshëm. Pra, për pranimin e suksesshëm të Ballkanit Perëndimor në BE, ne kemi nevojë për reforma të thella politike dhe ekonomike dhe harmonizim të AKUIS.

Euroskepticizmi i BE-së dhe lodhja me zgjerimin nuk duhet të përdoren nga politikanët e rajonit tonë si një justifikim për të mos u reformuar. Pa reformim nuk ka zhvillim dhe përmirësim të jetës së qytetarëve.

Së këndejmi, ne si Kosovë, nëse do t'i nënshtroheshim logjikës së populizmit, nuk do të angazhoheshim në dialog me Serbinë. Pra, nuk do të punonim në drejtim të një marrëveshjeje përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve dhe pajtim me Serbinë. Po të përfilleshin ndjenjat populiste, demarkacioni i kufirit midis Kosovës dhe Malit të Zi nuk do të kishte kaluar kurrë në Kuvend.

Unë dëshiroj të shpreh mirënjohje të lartë falënderimi për autoritetet në Mal të Zi, që treguan vazhdimisht mirëkuptim dhe durim në qasjen e institucioneve të Republikës së Kosovës për këtë problematikë, e cila ishte më tepër e skenës së brendshme politike të Kosovës.

Pak ditë më parë u mbajt edhe Samiti në Sofje i Bashkimit Evropian, ku të pranishëm ishin edhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Për Kosovën kjo ishte pjesëmarrja e parë në nivel të barabartë me vendet e tjera në samit.

Ishte pjesëmarrje afirmative për shtetin e Kosovës ku morën pjesë të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, me përjashtim të kryeministrit të Spanjës. Aty dëgjuam edhe mesazhet e qarta se vetë Bashkimi Evropian ka nevojë për modernizim, ka nevojë për reforma.

Ne dëgjuam edhe mesazhin e qartë dhe unik nga liderët e institucionit të Bashkimit Evropian dhe liderët e shteteve anëtare, se vendet e Ballkanit Perëndimor duhet t'i zgjidhin të gjitha çështjet e hapura që kanë mes vete, sepse askush nuk do t'i pranojë më problematikat që mund t'i kenë njëra me tjetrën dhe pa i përmbyllur reformat e nevojshme.

Përmbyllja e demarkacionit Kosovë - Mal i Zi, mundësia e përmbylljes së procesit për zgjidhjen e emrit midis Maqedonisë dhe Greqisë, vazhdimi i dialogut me Serbinë dhe përfundimi i suksesshëm në një të ardhme të afërt, do të ishin shenja të mira nga rajoni ynë për BE-në.

Kosova i mirëpret këto angazhime. Ndërkaq, është koha që udhëheqësit e Evropës ta marrin përgjegjësinë dhe të mos ndjekin politikat reaguese për përfitime afatshkurtra. Pra, të shohim se çfarë është e mirë për Evropën në një afat të gjatë. Përgjigjja është e qartë: një BE e zgjeruar që përfshin Ballkanin Perëndimor në tërësi. Ballkanasit nuk janë të përkryer, por janë evropianë të mirë. Kjo duhet ta rrisë përgjegjësinë te ne dhe të jemi të vëmendshëm se nuk do të jetë dhuratë e ardhmja evropiane, por përgjegjësi.

**(Shkrim i shkëputur nga fjalimi i presidentit Hashim Thaçi, i mbajtur në Forumin e Tetë "To be Secure" (2BS), në kuadër të panelit "Evropa e djathtë për momentin", Budvë, 22 maj 2018)**

# Thaçi pret në takim Arta Ramën: Gjykata Kushtetuese, simbol i unitetit

**Prishtinë, 23 maj (ER)** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të mërkurën në takim kryetaren e Gjykatës Kushtetues të Kosovës, Arta Rama. Me këtë rast, Thaçi ka uruar Ramën për marrjen e mandatit të dytë në krye të Gjykatës Kushtetuese si dhe ka përgëzuar atë për punën profesionale të kësaj gjykate. Presidenti Thaçi ka thënë se Gjykata Kushtetuese është simbol i unitetit qytetar dhe shtyllë kryesore e shtetit tonë. "Kryetaren Rama e urova për punën profesionale të Gjykatës Kushtetuese dhe i dëshirova suksese të mëtejme në mandatin e ri. Gjykata Kushtetuese është simbol i unitetit qytetar dhe shtyllë kryesore e shtetit tonë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Në seancën administrative të mbajtur më 22 maj, në përputhje me nenin 114, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës kanë votuar kryetaren aktuale Arta Rama për një mandat të dytë në krye të Gjykatës Kushtetuese. Rama do ta fillojë mandatin e ri në krye të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës më 26 qershor, kur edhe përfundon mandati i saj i parë.

Mandati i kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është tri vjet.



## Trefishohet numri i britanikëve që kanë kërkuar shtetësi gjermane



BERLIN, 23 MAJ - Zyrtarët gjermanë kanë thënë se ka thyer rekord numri i britanikëve që janë pajisur me shtetësi gjermane vitin e kaluar dhe krejt kjo mund të jetë e lidhur me referendumin e Britanisë për largim nga Bashkimi Evropian, transmeton "AP".
Brexiti i ka detyruar shtetasit britanikë të kërkojnë pasaporta nga shtetet e BE-së në mënyrë që ta ruajnë të drejtën për të jetuar apo punuar në vendet më të fuqishme në bllok.
Zyra Federale e Statistikave në Gjermani ka thënë të mërkurën se 7 493 britanikë janë natyralizuar më 2017, duke shënuar trefishim të numrit të personave të interesuar për ta ndërruar shtetësinë. Britanikët janë listuar të dytët në këtë aspekt, pasi po kjo zyrë ka treguar se turqit kanë qenë në krye të listës sa iu përket kërkesave për ta fituar shtetësinë gjermane.

# Takimi Trump - Kim dhe dyshimet rreth zhvillimit të tij

Koreja e Veriut nisi të hedhë hije dyshimi mbi mundësitë e mbajtjes së takimit Trump - Kim, pasi Shtetet e Bashkuara dhe Koreja e Jugut nisën manovrat ushtarake



UASHINGTON, 23 MAJ - Presidenti amerikan Donald Trump tha se nuk është i sigurt nëse takimi i tij me udhëheqësin e Koresë Veriore do të zhvillohet. Megjithatë, sipas tij, po ecet përpara me planet në lidhje me këtë çështje, pavarësisht prej kërcënimeve të Koresë së Veriut për të hequr dorë nga takimi i nivelit të lartë. Komentet e tij Trumpi i bëri gjatë një takimi me presidentin e Koresë së Jugut, Moon-Jae-in.
Takimi i presidentit Trump me homologun e Koresë së Jugut në Shtëpinë e Bardhë u zhvillua në një kohë kur takimi i tij muajin e ardhshëm me udhëheqësin e Phenianit, Kim Jong Unin, mbetet në pikëpyetje. "Ka disa kushte që ne duam të jenë dhe mendoj se do t'i vendosim. Nëse kjo nuk ndodh, nuk ka takim. Nëse nuk ndodh tani, ndoshta do të ndodhë më vonë", tha presidenti Trump.
Koreja e Veriut nisi të hedhë hije dyshimi mbi mundësitë e mbajtjes së takimit, pasi Shtetet e Bashkuara dhe Koreja e Jugut nisën manovrat ushtarake, si dhe pas sugjerimit të këshilltarit amerikan për Sigurinë Kombëtare, John Bolton, për zbatimin e "modelit libian" për kryerjen e çarmatimit bërthamor të Phenianit, kjo si referencë ndaj udhëheqësit të Libisë, Moammar Gadhafi, i cili i dorëzoi armët bërthamore që dispononte vendi i tij në vitin 2003.
Tetë vjet më pas ai u rrëzua nga pushteti. Ai u hodh në kanal dhe u qëllua në kokë, gjatë një kryengritjeje të mbështetur nga Shtetet e Bashkuara.
Presidenti Trump këmbënguli se udhëheqësi i Phenianit nuk ka asnjë arsye të shqetësohet, nëse heq dorë nga armët bërthamore. "Po, ne do t'i garantojmë atij sigurinë dhe kemi folur për këtë që në fillim. Ai do të jetë i sigurt, i lumtur. Vendi i tij do të jetë i pasur, do të punohet fort dhe do të jetë shumë i begatë", tha ai.
Por, ndërkohë Koreja e Veriut ka vazhduar kritikat e forta ndaj manovrave të përbashkëta ushtarake mes ShBA-së dhe Koresë së Jugut, ashtu siç po përgatitet ta shkatërrojë këtë objekt ku kryhen prova bërthamore, në Bregun Lindor, më vonë gjatë kësaj jave. Sipas ekspertëve, sinjalet e ndryshme që vijnë nga Pheniani janë rezultat i dekadave të tëra armiqësie, që nuk mund të tejkalohen lehtë. "Ka shumë mosbesim te të dyja palët, se ideja për atë që dikur quhej 'veprim në këmbim të veprimit', pra nëse ata bëjnë diçka, ne bëjmë diçka dhe kështu gradualisht ndërtohet besimi. Mendoj se kjo ndoshta do të jetë qasja e presidentëve Trump e Moon në raport me Phenianin", thotë Robert Manningu i Këshilliy të Atlantikut. Nëse kjo do të funksionojë, mbetet për t'u parë.

# Nikolla Gruevski dënohet me dy vjet burgim



SHKUP, 23 MAJ - Ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikolla Gruevski, është dënuar me dy vjet burgim për shpërdorim detyre në rastin e blerjes së një automjeti qeveritar në vlerë të 580 mijë eurove.
Ish-ndihmësministri i Punëve të Brendshme, Gjoko Popovski, është dënuar me gjashtë vjet e gjysmë burgim, ndërsa proces i veçantë gjyqësor për këtë rast është duke u zhvilluar edhe ndaj ish-ministres së Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovska.
Akuza ka të bëjë me shkeljet ligjore në procesin e blerjes së automjetit të blinduar, "Mercedes-Benz". Gjykatësja Dobrila Kacarska tha se Nikolla Gruevski kishte kërkuar nga ish-ministrja e Brendshme, Gordana Jankullovska, ta nisë procedurën për blerjen e veturës, ndërsa kjo kishte nxitur Popovskin të favorizojë një kompani të afërt të saj në procedurat e tenderimit.
Gjykatësja tha se me shkeljet e bëra Gruevski ka nënçmuar dhe fyer qytetarët meqë pas shpinës së tyre dhe në fshehtësi është pajisur me veturë sipas dëshirës së tij. "Është nder të jesh bartës i funksionit, në veçanti kryeministër. Legjitimitetin e ka marrë nga qytetarët andaj dhe duhet të kujdeset për interesat e tyre. Por, në vend të kësaj, ai i ka nënçmuar qytetarët", ka deklaruar gjykatësja duke e shpallur fajtor Gruevskin dhe ish-zyrtarin e MPB-së.

## Emiratet e Bashkuara mohojnë rol në zgjedhjet amerikane



NJU JORK, 23 MAJ - Ministri i Shtetit për Çështjet e Jashtme i Emirateve të Bashkuara Arabe, Anwar Gargash, mohoi të ketë pasur përpjekje nga vendi i tij, për të ndikuar në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në Shtetet e Bashkuara, në favor në Donald Trumpit.
Javën e kaluar gazeta "The New York Times" njoftoi se djali i presidentit, Donald Trump i Riu, kishte pasur një takim ku kishin marrë pjesë përfaqësues nga Emiratet e Bashkuara Arabe dhe nga Arabia Saudite. Sipas "Times", një i dërguar i ka thënë Trumpit të Ri se krerët e të dy shteteve dëshironin ta ndihmonin Donlad Trumpin për t'i fituar zgjedhjet presidenciale.
Avokatët e Trumpit të Ri kanë thënë se takimi nuk pati ndonjë rezultat që, sipas gazetës, është një fakt që mund të tregojë se vende të tjera, përveç Rusisë, mund të kenë ndërhyrë, ose janë përpjekur të ndërhyjnë në zgjedhjet e 2016-s në favor të Trumpit.

Intervistë me Sheremet Ahmetajn e realizuar nga gazeta "Rilindja" në Prishtinë më 26 nëntor 1999

# Në burgun e Dubravës u vranë mbi 200 shqiptarë

- Thotë Sheremet Ahmetaj, ish-kryeshef i Drejtorisë së Policisë të MPM të Kosovës, i cili këto ditë u lirua pas plot pesë vjetësh të vuajtjes së burgut me akuzë, formim të Ministrisë së Brendshme të Kosovës. Në burgjet jugosllave ende dergjen mijëra shqiptarë. Ata përballen me tortura më barbare dhe janë të izoluar pa asnjë informatë për botën e Kosovën



Nga Behram HOTI

Nga burgu i Mitrovicës së Sremit këto ditë u lëshua Sheremet Ahmetaj, ish-kryeshef i Drejtorisë së Policisë të MPM-së të Kosovës, i cili u lirua pas plot pesë vjetëve të vuajtjes së burgimit me akuzë formim të Ministrisë së Brendshme të Kosovës. Sheremet Ahmetaj rrjedh nga një familje me traditë partiake nga fshati Radishevë - Skenderaj i Drenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen për punë të brendshme e kreu në Kamenicë të Sremit (Vojvodinë, shkollën e lartë për punë të brendshme e mbaroi me sukses të lartë në Beograd, si dhe fakultetin e sigurimit, mbaroi edhe ca kurse të ndryshme specialistike për lëmin e udhëheqjes së policisë… Gjatë punës disavjeçare në lëmin e udhëheqjes së policisë… Gjatë punës disavjeçare në lëmin e sigurisë në Kosovë u dalluan si një ndër kuadrot më të specializuara me një përgatitje të lartë profesionale, me orientim të qartë kombëtar, njerëzor dhe humanitar, si i tillë ishte në përcjellje të vazhdueshme nga shërbimi sekret serbosllav. Gjatë viteve të qëndresës kombëtare shqiptare për Kosovë dhe avancimin e pavarësinë e Kosovës (1981-1994) kur u arrestua, u dallua për angazhim dhe vigjilencë të lartë në ruajtën dhe mbrojtjen e popullit, sidomos të brezave të rinj, studentëve dhe nxënësve të Kosovës… Shi për këtë angazhim të tij, Shërbimi Sekret serbojugosllav më 22 nëntor 1994 e arreston dhe e burgos.

Sheremet Ahmetaj, në qelitë e errëta të Serbisë ndenji plot 5 vjet dhe një ditë më shumë. U dënua, e pretekst dhe akuza për formimin e Ministrisë së Brendshme të Kosovës.

*Z. Sheremet, kur dhe si u arrestuat?*

Organet e Shërbimit Sekret jugosllav kishin në shënjestër kuadrot, profesionistët e sigurimit të Kosovës, në mesin e tyre edhe unë. Ne ishim të vetëdijshëm për veprimtarinë sekrete të serbosllavisë kundër shqiptarëve të Kosovës. Serbia okupatore burgoste edhe fëmijë, femra shqiptare… Më arrestuan në Prishtinë më 22 nëntor 1994. Unë nuk ika kurrë nga Prishtina, as nga Kosova. Jam i lindur dhe i rritur në Radishevë të Drenicës, prandaj nuk mund t'ia kthej shpinën Drenicës.

*Z. Sheremet, atë vit u burgosën shumë punëtorë shqiptarë të cilët më parë punonin në organet e Punëve të Brendshme?*

Po në vitin 1994, Serbia arrestoi mbi 300 ish-punëtorë të shërbimeve të mbrojtjes dhe të sigurisë në Kosovë. Që të gjithë ishin shqiptarë. Por u ngrit akuza dhe u dënuan 173 prej tyre. Mua mu caktua paraburgimi dhe më dënuan me 5 vjet burgim të rëndë. Siç jeni në dijeni, dola kazamatet e Serbisë plot pas 5 vjetëve e një ditë më shumë, u lirova më 23 nëntor 1999. Pra, pa më lëshuar asnjë orë përpara afatit…

*A mund të na thoni diç edhe për burgun e Ministrisë së Sremit ku qëndruat kohën e fundit?*

Në burgun famëkeq të Prishtinës qëndrova plot 7 muaj e 15 ditë, i izoluar, nën torturat më mizore që mund të bëjë e të aplikojë vetëm pushteti serbosllav. Në burgun e Lipjanit qëndrova 1 vit. Burgu i Lipjanit është ferr dhe tmerr për të burgosurit shqiptarë. Vuanim edhe për bukë. Isha edhe në burgun e Dubravës dhe të Nishit, që është ndër burgjet më të rrezikshme për të burgosurit shqiptarë. Tërë kohën isha në izolim. Më 29 prill 1999, me dy autobus të mbushur me të burgosur shqiptarë, u përcollëm për në burgun e Dubravës së Istogut. Si duket kishin programuar dhe projektuar mirë skenarin për të na vrarë… Dhe, ashtu ndodhi.

*Z. Sheremet, çfarë ndodhi në fshatin Llazicë të Drenicës, derisa ju të burgosurit deportoheshit në burgun e Dubravës së Istogut?*

Pikërisht më 29 prill 1999 na deportuan nga burgu i Nishit për në Dubravë, siç ceka më parë. Në udhë në fshatin Llazicë të Drenicës, NATO-ja raketoi bazat ushtarake serbe te pishat e Llazicës. Goditi urën e Llazicës… Autobusët tanë ku ishim ne të lidhur me zinxhirë dhe pranga u ndalën në asfalt. Ne të lidhur me pranga shikonim se si ata iknin si minjtë dhe fshiheshin nëpër skuta skaj rruge. Pasi që kaloi raketimi ajror i NATO-s, na kthyen prapa për në burgun e Lipjanit, sepse ura u shkatërrua. Rrugës deri në Lipjan na torturuan e na u kërcënuan se do të na likuidojnë të gjithëve. Por shqiptarët e burgosur qëndronin dinjitoz të vetëdijshëm për çfarë flijoheshin. Në mesin e të burgosurve ishin edhe Bajrush Xhemajli, Hajredin Hyseni, Ismet Mahmuti etj.

Në burgun e Dubravës, në raketimin e parë të NATO-s, më 19 maj 1999, u vranë 3 shqiptarë, në raketimin e dytë, më 21 maj 1999, u vranë 19 shqiptarë të burgosur. Të gjithë shqiptarët në Dubravë u masakruan nga forcat serbe, dhe sipas burimeve tona janë vrarë mbi 200 shqiptarë.

Vdekjen e pamë shumë herë me sy, por, ja, ne jemi gjallë, në Kosovën tonë të dashur dhe të lirë… Ai që di pse ka rënë në burg nuk i duket i rëndë burgu….

Morali, dinjiteti, bujaria, fisnikëria, gatishmëria për flijim ndër shqiptarë në mes vete në momente të rënda kur e lyp nevoja dhe kur duhet, ka qenë gjithmonë në nivel që ja ka lakmi çdo komb në botë.

Pakot që na vinin nga pjesëtarët e familjeve që kishin në diasporë anëtarë të familjes, ato i ndanim për secilin të burgosur. Në burgun e Sremit të Vojvodinës, 91 shqiptarë kanë qenë të izoluar vetëm në një dhomë. U ngjanim fishekëve në rrethatore.

Edhe ashtu qëndronim. Një mollë na shuante urinë dhjetëra të burgosurve, një pako ushqimore na shërbente për të gjithë. Kështu jetonim e mbijetonim.

I falënderojmë të gjithë ata që u kujdesën për jetën tonë në burgjet e Serbisë. Apeloj tek familjarët shqiptarë në diasporë që t'u dërgojnë pako ushqimore të burgosurve shqiptarë, sepse ata kanë më shumë mundësi dhe forma për dërgimin e pakove ushqimore. Më së shumti na e rëndonte gjendjen mosinformimi. Jo vetëm shqiptarët, por edhe të burgosurit e kombeve të tjera, në burgjet e Serbisë që dy vjet janë të izoluar në terr të informimit. Këtë e bën me qëllim pushteti serb. Në asnjë burg në botë nuk shkelen konventat mbi lirinë dhe të drejtat e njeriut si në burgjet serbosllave! Nuk di pse vepron Serbia kështu.

I vetmi informim për Kosovën më erdhi nga bashkëshortja në pakon ushqimore, ku kishte fshehur me mjeshtri dhe kishte mbështjellë bukën me Marrëveshjen e nënshkruar në Rambuje. Atë e lexuam, e analizuam dhe e studiuam të gjithë të burgosurit shqiptarë, dhe pa u diktuar nga gardianët e asgjësuam.

Në ndarje nga Sheremet Ahmetaj, na mori ngryk nëna e tij plakë, që së bashku me nipat dhe mbesat i bashkohej gëzimit familjar, por uronte Zotin që të mëshiroj të gjithë shqiptarët, që të dalin sa më parë nga kazamatet serbe.

**(Kjo intervistë është botuar me rastin e 19-vjetorit të masakrës në burgun e Dubravës)**



E PREMTE, 26 NËNTOR 1999 Rilindja

NË BURGUN E DUBRAVËS U VRANË MBI 200 SHQIPTARË

*- thotë Sheremet Ahmetaj, ish-kryeshef i Drejtorisë së Policisë të MPM të Kosovës, i cili këto ditë u lirua pas plot 5 vjet të vuajtjes së burgut me akuzë - formim të Ministrisë së Brendshme të Kosovës. - Në burgjet jugosllave ende dergjen mijëra shqiptarë, ata përballen me tortura më barbare dhe janë të izoluar pa asnjë informatë për botën e Kosovën*

Nga burgu i Mitrovicës së Sremit këto ditë u lëshua Sheremet Ahmetaj, ish-kryeshef i Drejtorisë së Policisë të MPM-së të Kosovës, i cili u lirua pas plot 5 vjetëve të vuajtjes së burgimit me akuzë formim të Ministrisë së Brendshme të Kosovës. Sheremet Ahmetaj rrjedh nga një familje me traditë patriotike nga fshati Radishevë -Skënderaj i Drenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen për punë të brendshme e kreu në Kamenicë të Sremit (Vojvodinë), shkollën e lartë për punë të brendshme e mbaroi me sukes të lartë në Beograd,si dhe fakuhetin e sigurimit, mbaroi edhe ca kurse të ndryshme specialistike për lëminë e udhëheqjes së policisë... Gjatë punës disavjeçare në lëmin e sigurisë në Kosovë u dallua si një ndër kuadrot më të specializuara me një përgatitje të lartë profesionale, me orientim ë qartë kombëtar, njerëzor dhe humanir, si i tillë ishte në përcjellje të vazhduhme nga shërbimi sekret serbosllav. atë viteve të qëndresës kombëtare iptare për Kosovë dhe avansimin e arësinë e Kosovës (1981-1994) kur u stua, u dallua për angazhim dhe vigji- ë të lartë në ruajtjen dhe mbrojtjen e llit, sidomos të brezave të rinj, stuve dhe nxënësve të Kosovës... Shi ëtë angazhim të tij, Shërbimi Sekret jugosllav më 22 nëntor 1994 e on dhe e burgos.

neremet Ahmetaj, në qelitë e errëta bisë ndenji plot 5 vjet dhe një ditë umë. U dënua me pretekst dhe për formimin e Ministrisë së hme të Kosovës.

*emet, kur dhe si u arrestuat?*

*ganet e Shërbimit Sekret jugosllav ë shënjestër kuadrot, profesiongurimit të Kosovës, në mesin e edhe unë. Ne ishim të vetëdiveprimtarinë sekrete të serbonder shqiptarëve të Kosovës. atore burgoste edhe fëmijë. re... Më arrestuan në Prishtor 1994. Unë nuk ika kurrë s nga Kosova. Jam i lindur Radishevë të Drenicës, nd t'ia ktheja shpinën*

të gjithë ishin shqiptarë. Por, u ngrit akuza dhe u dënuan 173 prej tyre. Mua m'u caktua paraburgimi dhe më dënuan me 5 vjet burg të rëndë. Siç jeni në dijeni, dola nga kazamatet e Serbisë plot pas 5 vjetëve e një ditë më shumë - u lirova më 23 nëntor 1999. Pra, pa më lëshuar asnjë orë përpara afatit...

***A mund të na thoni diç edhe për burgun e Mitrovicës së Sremit ku qëndruat kohën e fundit?***

Në burgun famëkeq të Prishtinës qëndrova plot 7 muaj e 15 ditë, i izoluar, nën torturat më mizore që mund të bëjë e të aplikojë vetëm pushteti serbosllav. Në burgun e Lipjanit qëndrova 1 vit. Burgu i Lipjanit është ferr dhe tmerr për të burgosurit shqiptarë. Vuanim edhe për bukë. Isha edhe në burgun e Dubravës dhe të Nishit, që është ndër burgjet më të rrezikshme për të burgosurit shqiptarë. Tërë kohën isha në izolim. Më 29 prill 1999, me dy autobusë të mbushur me të burgosur shqiptarë, u përcollëm për në Burgun e Duravës së Istogut. Si duket e kishin projektuar dhe programuar mirë skenarin për të na vrarë... Dhe, ashtu ndodhi.

***Z.Sheremet, çfarë ndodhi në fshatin Llazicë të Drenicës, derisa ju të burgosurit deportoheshit në burgun e Duravës së Istogut?***

Pikërisht më 29 prill 1999, na deportuan nga burgu i Nishit për në Dubravë, siç ceka më parë. Në udhë, në fshatin Llazicë të Drenicës, NATO raketoi bazat ushtarake serbe te pishat e Llazicës. Goditi urën e Llazicës... Autobusët tanë ku ishim ne të lidhur me zinxhirë dhe pranga u ndalën në asfalt. Ne të lidhur me pranga shikonim se si ata iknin si minjtë dhe fshiheshin nëpër skuta skaj rruge. Pasi që kaloi raketimi ajror i NATO-s, na kthyen prapa për në burgun e Lipjanit, sepse ura u shkatërrua. Rrugës deri në Lipjan na torturuan e na u kërcënuan se do të na likuidojnë të gjithëve. Por shqiptarët e burgosur qëndronin dinjitozë të vetëdijshëm se për çfarë flijoheshin. Në mesin e të burgosurve ishin edhe Bajrush Xhemajli, Hajredin Hyseni, Ismet Mahmuti etj.

Në Burgun e Dubravës, në raketimin e parë të NATO-s, më 19 maj 1999

Sheremet Ahmetaj

por, ja, ne jemi gjallë, në Kosovën tonë të dashur dhe të lirë... Ai që di pse ka rënë në burg nuk i duket i rëndë burgu...

Morali, dinjiteti, bujaria, fisnikëria, gatishmëria për flijim ndër shqiptarë në mes vete në momente të rënda kur e lyp nevoja dhe kur duhet, ka qenë gjithmonë në nivel që ia ka lakmi çdo komb në botë.

Pakot që na vinin nga pjesëtarët e familjeve që kishin në diasporë anëtarë të familjes, ato i ndanim për secilin të bur gosur. Në burgun e Sremit të Vojvodinë 91 shqiptarë kanë qenë të izoluar vetë në një dhomë. U ngjanim fyshekëve rrathatore.

Edhe ashtu qëndronim. Një mollë shuante urinë e dhjetëra të burgosur një pako ushqimore na shërbente për gjithë. Kështu jetonim e mbijetonim.

I falënderojmë të gjithë ata që u desën për jetën tonë në burgjet e Serb Apeloj tek familjarët shqiptarë në sporë që t'u dërgojnë pako ushqimo burgosurëve shqiptarë. sepse ata kan shumë mundësi dhe forma për dërgir pakove ushqimore.

Më së shumti na e rëndonte gje mosinformimi. Jo vetëm shqiptarë edhe të burgosurit e kombeve të tje burgjet e Serbisë që dy vjeit janë të ar në terr të informimit. Këtë e bën lim pushteti serb. Në asnjë burg nuk shkilen konventat mbi lirtë drejtat e njeriut si në burgjet serb Nuk di pse vepron Serbia kështu.

I vetmi informim për Koso erdhi nga bashkëshortja në pako more, ku kishte fshehur me mje kishte mbështjellë bukën me M jen e nënshkruar në Rambuje. am, e analizuam dhe e studiua të burgosurit shqiptarë. dhe

# RAYMOND CARVER



Raymond Carver (1938-1988), poet, prozator dhe eseist. Ishte një nga ata pak shkrimtar bashkëkohor amerikan që e revitalizoi tregimin e shkurtër pikërisht në kohën kur filloi të konsiderohej si formë letrare pothuajse e vdekur. Ishte një ndër shkrimtarët më me ndikim në gjysmën e dytë të shekullit të njëzet dhe u konsiderua si një nga shkrimtarët më të mëdhenj të prozës së shkurtër. Edhe pse i njohur më shumë si tregimtar, ai në realitet veten e konsideronte së pari poet: "Mendoj se nuk jam i interesuar në atë që mund ta quani poezi e shkruar mirë. Kur e shoh një poezi të tillë jam i tunduar të reagoj duke thënë: 'Oh, kjo është veç poezi'. Unë kërkoj diçka tjetër, diçka që nuk është veç poezi e mirë".

*Është autor i disa librave me tregime: Will You Please Be Quiet, Please? (1976), What We Talk About When We Talk About Love (1981), Cathedral (1984). Dhe i librave me poezi: Near Klamath (1968), Winter Insomnia (1970), Fires (1983), Where Water Comes Together With Other Water (1985) etj.*

## JETA TJETËR

*Tash për jetën tjetër. Atë*
*pa gabime.*
-LOU LIPSITZ

Gruaja ime është në gjysmën tjetër të kësaj shtëpie të lëvizshme
duke përgatitur një çështje gjyqësore kundër meje.
Mund ta dëgjoj stilolapsin e saj si gërvin, gërvin.
Herë pas here ajo ndalet për të qarë,
pastaj gërvin, gërvin.

Mrazi po fashitet nga toka.
Njeriu që ka këtë bllok më thotë:
Mos e le automobilin tënd këtu.
Gruaja ime vazhdon të shkruajë dhe të qajë,
të qajë dhe të shkruajë në kuzhinën tonë të re.

## PARAJA

Në mënyrë që njeriu
të mos bie ndesh me ligjin.
Që gjithmonë ta përdorë emrin e vet
dhe numrin e telefonit. Të jetë dorëzan
për miken dhe që të mos t'ia
ndiejë po qe se mikja e braktis qytetin.
Të shpresojë, në fakt, se ajo do të shkojë
T'i japë ca para nënës
Edhe fëmijëve të vet
dhe nënës së tyre.
Që mos t'i kursejë. Ai dëshiron
që t'i shpenzojë me mend para se t'i bëjë rrush e kumbulla.
Të blejë tesha me to.
Ta paguajë qiranë dhe shërbimet publike.
Të blejë ushqim dhe ndonjë gjë tjetër.
Të dalë për darkë kur t'i teket.
Dhe të jetë gjithçka në rregull
kur të porositë çfarëdo jashtë menysë!
Të blejë drogë kur ia kënda.
Të blejë automobil. Po qe se prishet,
ta rregullojë. Ose edhe më mirë
të blejë një tjetër. E sheh atë
anije? Ai do të mund ta
blinte sa çel e mbyll sytë. Dhe të lundrojë
rreth e rrotull Hornit, duke kërkuar
shoqëri. Ai e njeh një vashë
në Porto Alegre që do të donte
ta shihte në anijen e vet, plot me vela,
dhe të ankorohet në port për të.
Tipi që do të mund ta kalonte
gjithë atë rrugë
për ta parë atë. Sall për shkak se
i pëlqente qeshja
e zëshme e saj,
dhe mënyra si tund flokët.

## NË VITIN 2020

Cili prej nesh do të mbetet atëherë -
plak, i shushatur, i pasigurt -
por i vullnetshëm për të folur për miqtë tanë të vdekur?
Për të folur e folur, si një rubinet i vjetër që pikon.
Kështu që të rinjtë,
të respektueshëm, kureshtarë në mënyrë prekëse,
do të nxiten
nga kujtimet.
Me përmendjen e këtij emri
apo atij emri, dhe atë që e kemi bërë së bashku.
(Ashtu siç ishim ne të respektueshëm, por kureshtarë
dhe të ngazëllyer, për të dëgjuar dikë që do të tregonte
për të vdekurin e shquar përpara nesh)
për cilin prej nesh do t'u flasin
miqve të tyre,
ai e ka njohur filanin dhe fistekun! Ishte mik me -
dhe kalonin kohën së bashku.
Ai ishte në atë ndejën e madhe.
Të gjithë ishin atje. Festuan dhe
kërcyen deri në agim. I vunë krahët njëri-tjetrit dhe kërcyen
deri kur lindi dielli.
Tash të gjithë ata janë të vdekur.
Për cilin prej nesh do të thuhet -
ai i njihte ata? I ka shtrënguar duart me ta
dhe i ka përqafuar ata, ka bujtur
në shtëpitë e tyre të ngrohta. I ka dashur!

Miq, ju dua, është e vërtetë.
Dhe shpresoj se jam mjaft me fat, mjaft i privilegjuar
për të jetuar dhe për të dëshmuar.
Besomëni, do të them sall gjërat me të
lavdishme për ju dhe kohën tonë këtu!
Ngase për të mbijetuarin do të duhej të ketë diçka
që të mund të vazhdojë tutje. Të plaket,
t'i humbas të gjitha dhe të gjithë.

## E MUNDUR

Kam kaluar vite, me ndërprerje, nëpër universitete.
Kam ligjëruar në vende ku nuk mund të afrohesha
si student. Ama kurrë as një rresht nuk e kam shkruar
për atë kohë. Kurrën e kurrës. Asgjë nuk ka mbetur
në mua nga ato ditë. Isha i huaj,
dhe mashtrues, bile edhe ndaj vetes sime. Përveç
në një shkollë. Në atë institucionin e shquar në
Perëndimin e Mesëm. Ku
miku im i vetëm dhe kolegu im,
Chaucerian, ishte arrestuar për shkak se kishte rrahur gruan e vet.
Dhe iu kishte kërcënuar me jetë në telefon,
me prapësi. Ai donte t'ia nxirrte sytë.
Ta digjte në zjarr për tradhti bashkëshortore.
Tipin me të cilin ajo takohej, ky donte ta ngulte
në dhe si hu gardhi.

Ai e humbi mendjen për një kohë, ndërsa ajo ia filloi
një jete të re. Pas kësaj, ai i mbante
ligjëratat i dehur dhe duke qarë. Më shumë se një herë
këmishën e kishte të përlyer me ushqim.
Unë nuk mund t'i ndihmoja. Edhe unë vetë isha si guri në rrokullimë.
Ama duke parë mënyrën se si po jetonte, si të them,
nuk isha larguar edhe aq larg nga shtëpia,
megjithatë. Miku im i ditur. Shoku im i vjetër.
Më në fund jam jashtë gjithë kësaj vakie.
Dhe për ty. Lutem që të të mos dridhen duart
dhe që të jesh i lumtur sonte. Shpresoj që ndonjë grua
sapo e ka futur dorën nën jakën tënde të pastër
dhe që të ka thënë se të do.
Besoji, nëse mundesh, sepse është e mundur se ajo e ka me gjithë mend.
Është dikush që do të jetë besnik dhe i sjellshëm ndaj teje.
Gjatë të gjitha ditëve që të kanë mbetur.

## VDEKJA IME

Po qe se kam fat, do të jem i lidhur me turlifarë telash
për krevatin e spitalit. Gypat do t'm'i fusin
në hundë. Por përpiquni të mos keni frikë nga unë, miq!
Po jua them që tash se kjo është në rregull.
Tekembramja nuk po ju kërkoj edhe aq shumë.
Dikush, shpresoj, do t'ju telefonojë të gjithëve
për t'ju thënë: "Eja shpejt, ai po jep shpirt!"
Dhe të gjithë do të vijnë. Do të kem kohë
të hallallohem me të gjithë të dashurit e mi.
Po qe se kam fat, ata do të më afrohen
dhe unë do të jem në gjendje t'i shoh për herë të fundit
dhe ta marr me vete atë kujtim.
Sigurisht, do të më shikojnë dhe do të dëshirojnë të largohen me vrap
e të ulërijnë. Por, pasi që më duan,
do të ma ngrehin dorën dhe do të thonë: "Mbaju trimërisht"
ose "Çdo gjë do të bëhet mirë".
Dhe mirë e kanë. Çdo gjë është në rregull.
Bash mirë është. Sall po ta dinit se sa të lumtur më keni bërë!
Po shpresoj se fati s'do të më braktisë, dhe do të mund t'i bëj
do shenja të njohjes.
T'i hap dhe mbyll sytë sikur të thosha:
"Po, po të dëgjoj. Po të kuptoj".
Bile do t'më shkoj ndoresh t'ju them diçka të këtillë:
"Edhe unë ju dua. Jini të lumtur".
Po shpresoj për një gjë të tillë! Ama nuk dua të kërkoj shumë.
E po qe se nuk kam fat, ashtu siç e meritoj, ani mirë, vetë do të
bie, ashtu, pa kurrfarë gjase
për t'u përshëndetur ose për t'ia shtrënguar dorën ndokujt.
Ose të them se sa shumë ua kam mbajtur gajlen dhe jam kënaqur
në shoqërinë tuaj gjatë gjithë këtyre viteve. Sidoqoftë.
përpiquni të mos vajtoni shumë për mua. Dua që të dini
se kam qenë i lumtur derisa isha këtu.
Dhe mbajeni mend, se këtë ua kam thënë para do kohe - në prill 1984.
Por jini të lumtur po qe se jap shpirt në praninë
e miqve dhe familjes. Nëse ndodhë kjo, besomëni,
Ia kam dal mbanë. Kësaj radhe nuk kam humbur.



## ZJARRGËLLTITËSIT E RINJ TË MEKSIKO SITIT

Ata e mbushin gojën me alkool
dhe e fryjnë atë mbi qiririn e ndezur
në semaforë. Kudo, përnjëmend,
aty ku automobilat bëhen varg ndërsa shoferët
janë të zemëruar dhe të frustruar dhe kërkojnë
argëtim - aty do t'i gjeni
zjarrgëlltitësit e rinj. Këtë që bëjnë e
bëjnë për disa pesosë. Po qe se kanë fat.
Por pas një viti buzët
i kanë të përzhitura ndërsa fytat të dërmishur.
Brenda vitit e humbin zërin.
S'mund të flasin as të bërtasin -
këta fëmijë të heshtur që dalin në gjueti
rrugëve me një qiri
dhe me një kanaçe birre të mbushur me alkool.
Ata quhen milusos. E në përkthim
do të thotë për "një mijë dispozicione".

## LEXIMI

Jeta e çdo njeriu është mister, bile bash njashtu
siç është e jotja, dhe jeta ime. Imagjinoje
një kështjellë me dritare që shohin
nga Liqeni i Gjenevës. Aty në dritare
gjatë ditëve të ngrohta dhe me diell një njeri
aq i thelluar në lexim sa që nuk ngre
shikimin fare. Ose nëse e ngre shikimin ai e shënjon
me gisht vendin, i ngre sytë, dhe vështron ngultas
matanë ujit në Mont Blan,
dhe përtej, në Selah, Uashington,
ku ai është me një vashë
dhe po dehej për herë të parë.
Gjënë e fundit që e mban mend, para
se t'i humbte ndjenjat, është se ajo e kishte pështyrë.
Ai ende vazhdon të pijë
dhe me vite të pështyhet nga të tjerët.
Por disa njerëz do të të thonë
se vuajtja i bën mirë karakterit.
Je i lirë të besosh çfarë të duash.
Për çdo rast, ai
i kthehet leximit dhe nuk do të
ndihet fajtor për shkak të nënës së vet
që endet në barkën e trishtimit të saj,
as ta çaj kokën për fëmijët e vet
dhe hallet e tyre që s'pushojnë kurrë.
As që ka për qëllim të mendoj
mbi gruan syndritur që dikur e dashuronte
dhe mbi humbjen e saj në duart e religjionit lindor.
Dhimbja e saj nuk ka fillim, dhe as mbarim.
Lëreni cilindo qoftë nga kështjella apo Selahu,
të bëj një hap para e që mund të jetë i afërt me njeriun
që rri gjithë ditën në dritare dhe lexon,
si një fotografi e njeriut që lexon.
Le të dalë dielli.
Le të vijë vetë njeriu.
E çfarë dreqin është duke lexuar ai njeri?

## MJEKËSIA

Krejt çfarë di në lidhje me mjekësinë e kam mësuar
nga miku im mjek në El Paso
i cili pinte dhe drogohej. Ishim shokë për kokë
derisa u shpërngula në Lindje. Po e theksoj
se në jetë kurrë nuk kam qenë i sëmurë as një ditë të vetme.
Por diçka m'u paraqit në
shpatull dhe ende vazhdon të rritet.
Një ateromë, mendoj, dhe më pëlqen kjo fjalë
ama jo edhe vetë ajo gjë, çfarëdo qoftë ajo.
Natën vonë dhëmbët më dhembin
edhe telefoni cingëron. Jam i sëmurë,
i pikëlluar dhe i vetmuar. O Zot!
Ma jep thikën tënde të paqëndrueshme,
doktoro! Ma jep dorën tënde, miko!

## MBRËMJA

Peshkoja i vetëm asaj mbrëmje vjeshte pa gjallëri.
Peshkoja derisa errësira vazhdonte të arrinte.
Duke përjetuar humbje të pazakontë dhe pastaj
gëzim të pazakontë kur e solla salmonin e argjendtë
deri te barka, dhe futa mrezhën përfundi peshkut.
Zemër e fshehtë! Kur e shikova në ujin që rridhte
dhe lart në përvijimin e errët të bjeshkëve
prapa qytetit, asgjë s'më paralajmëronte atëherë
se do të më merrte malli kaq shumë
për t'u kthyer këtu edhe një herë, para se të vdisja.
Larg çdo gjëje, dhe larg nga vetvetja.

## SHTËPIA PRAPA KËSAJ SHTËPIE

Ajo pasdite ishte tashmë e errët dhe e panatyrshme.
Kur kjo plakë u shfaq në fushë,
në shi, duke bartur kapistrën.
U ngjit përpjetë rrugës për te shtëpia.
Te shtëpia prapa kësaj shtëpie. Në njëfarë mënyre
ajo e dinte se Antonio Rios ishte
futur në orën e betejës së tij të fundit.
Disi, mos më pyetni se si, ajo këtë e dinte.

Doktori dhe disa njerëz të tjerë ishin pranë tij.
Ama asgjë më tepër s'mund të bëhej. Dhe kështu
plaka futi kapistrën në dhomë,
dhe e vari në këmbë të shtratit.
Të shtratit ku ai përpëlitej dhe jepte shpirt.
Ajo doli pa e thënë asnjë fjalë.
Kjo grua që dikur kishte qenë e re dhe e bukur.
Kur Antonio ishte i ri dhe i bukur.

**(Marrë nga numri i dytë i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia".
Përktheu nga anglishtja: Fadil Bajraj)**

# Celine Dion kthehet në skenë dy muaj pas operimit



Dy muaj pasi Celine Dion ka anuluar disa spektakle në Las Vegas për t'iu nënshtruar një "procedure minimale invazive kirurgjikale", ajo u kthye në skenë në The Colosseum në Caesars Palace të martën mbrëma. Fituesja e çmimit Grammy e nisi natën duke iu drejtuar sallës së mbushur me njerëz ku edhe u prit me ovacione.

# Pesë milionë klikime merr për një javë "Ma Cherie"



Këngëtari i njohur Butrint Imeri javën e kaluar ka prezantuar për fansat projektin e tij më të ri me titull "Ma Cherie". Kjo këngë është pritur mirë nga fansat, teksa këtë e tregojnë edhe shifrat e larta të klikimeve në kanalin "YouTube". Për vetëm një javë pas publikimit të saj, "Ma Cherie" numëron mbi pesë milionë klikime në "YouTube".



# Gomezi e kujdesshme me shëndetin, lë edhe alkoolin

Selena Gomez u rikthye në skenë javën që lamë pas. Gomezi, e cila ka kaluar dy javë në një shtëpi rehabilituese dhe iu nënshtrua transplantimit të veshkës, është duke u treguar tejet e kujdesshme për shëndetin. Sipas burimeve të afërta me këngëtaren, Selena ka hequr dorë edhe nga alkooli. Ajo ka treguar më parë se kishte probleme me ankthin dhe depresionin.

# Martohet Cristiano Ronaldo?



E dashura bukuroshe e Cristiano Ronaldos, Georgina Rodriguez, solli në jetë vajzën e tyre Alana Martina gjashtë muaj më parë, vetëm një vit pas lidhjes me futbollistin. Por duket se gjërat mes çiftit të famshëm kanë shkuar në një tjetër nivel. Në fotografitë e reja nga pushimet e tyre romantike në Ibiza, Georgina ka shfaqur një diamant në gishtin e unazës, një tregues ky se shumë shpejt ajo dhe sulmuesi i Real Madridit do të martohen.

E jashtëzakonshme

## Paditët kirurgia që këndoi dhe kërceu mbi pacientët



Një kirurge e vetëshpallur "shumë kompetente" në Atlanta po përballet me disa padi për neglizhencë pasi ka postuar video në "YouTube" duke kënduar dhe vallëzuar mbi pacientët e pavetëdijshëm. Sipas WSB-TV Atlanta, një nga paditë e ngritura kundër kirurges e akuzon atë për shkaktimin e dëmtimit të përhershëm të trurit pas kryerjes së një liposukure në vitin 2016.

FOTO E DITES



Një zog që qëndron mbi kokën e një dreri në jugperëndim të San Salvadorit. /AFP/

E rrallë

## Estonia nga 1 korriku ofron transport publik falas



Estonia ka vendosur ta ofrojë transportin publik falas për banorët në pjesën më të madhe të vendit duke nisur nga 1 korriku. Zona e lirë falas do të zhvillohet 24 orë në ditë për gjithë javën. Ky është vendi i parë që heq të gjitha përfitimet që merr nga lëvizja e njerëzve që përdorin transport publik.

## BARSOLETA E DITËS



**Gjyqtari e pyet dëshmitarin:**
**- E dini se ç'do të fitoni me dëshmi të rrejshme.**
**- Po, e di. I akuzuari ma ka premtuar një automobil.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetem gjate vikendit në ora 15:00**

### "AVENGERS: Infinity War" 3D,



Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Soldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo




**Në ora 18:00**

### "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson

**Në ora 16:00 dhe 20:00**

### "DEADPOOL 2" (R)




Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

**Regjia:** David Leitch

**Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.**




**Në ora 22:00**

### "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot është një ditë e mirë për të krijuar miqësi të reja dhe për të parë fytyra të reja. Çdo gjë po ju duket shumë monotone.



**DEMI**
Edhe pse sot mendoni për punën dhe karrierën, do të vëreni se nuk mund t'i anashkaloni çështjet e zemrës dhe partnerin.



**BINJAKËT**
Sot po mundohen t'ju vënë shkopinj nën rrota. Kjo gjë nuk do t'ju pengojë aspak të arrini ato synime që ia keni vënë vetes.



**GAFORRJA**
Po ndieni që rehatia ka mbaruar dhe kjo gjë s'po ju pëlqen. Një gotë verë në mbrëmje do të kalojë në biseda shumë të ngrohta me partnerin.



**LUANI**
Dita do të nisë pak e zymtë sot për shkak të një takimi që nuk do të shkojë dhe aq mirë. Pasdita do të jetë e përkryer.



**VIRGJËRESHA**
Sjellja juaj e mbyllur, pesimiste dhe superkritike, sot do të krijojë probleme të mëdha në komunikim.



**PESHORJA**
Edhe pse po dëgjoni shumë fjalë vërdallë përsëri kjo gjë nuk do ta prishë harmoninë në çift. Sot do të jetë një ditë e bukur dhe e qetë për ju.



**AKREPI**
Nuk keni dhënë shumë nga vetja në një çështje që është më e rëndësishme siç mendoni. Do të prisni që gjërat të qetësohen, por do të jetë vonë.



**SHIGJETARI**
Sapo keni dalë nga një lidhje e rëndësishme për ju dhe kjo gjë ju ka tronditur disi. Për ata që presin rritje në karrierë nuk ka ardhur ende momenti.



**BRICJAPI**
Jeni duke menduar se si do ta kaloni ditën dhe e keni gjetur zgjidhjen. Në shoqërinë e miqve do të kaloni çaste shumë të këndshme.



**UJORI**
Paraqitet një ditë shumë e nxehtë për këtë shenjë. Flirte të reja në horizont dhe mjaft ngjarje që do të përfundojnë në takime të rëndësishme.



**PESHQIT**
Jeni të hapur dhe të sinqertë me të gjithë sot. Kjo është një veçori e juaja. Një udhëtim i shkurtër jashtë monotonisë pritet nga ju.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi
Servisim
Porosi

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| TRELLEBORGS - BROMMAPOJKARNA | 1 | NORRBY IF -HELSINGBORGS | 2 | DALKURD - ELFSBORG | GG |

# Ferizaj kërkon rikthimin, Vëllaznimi qëndrimin në Superligë



Qëndrim Dautaj po beson se Ferizaj pas një viti qëndrim në Ligën e Parë e ka kohën të rikthehet në Vala Superligën e Kosovës në futboll, kurse Egzon Gashi ka thënë se skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova meriton që edhe në të ardhmen të jetë pjesë e elitës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 MAJ - Superliga është synim kryesor i Ferizajt dhe Vëllaznimit, të cilat përballen sot (e enjte) në kuadër të ndeshjes së dytë të barazhit. Ferizaj pas një edicioni të mirë në Ligën e Parë po kërkon të rikthehet në Vala Superligën e Kosovës në futboll, për çfarë është mjaft optimist një prej futbollistëve më të mirë në këtë skuadër, Qëndrim Dautaj.
Futbollisti nga Deçani ka thënë për gazetë se Ferizaj do ta japë maksimumin në ndeshjen e vitit për t'u rikthyer në rangun më të lartë të futbollit në vend. "Synimet tona janë që me lojë të mirë t'i kënaqim ata shikues që vijnë ta shikojnë ndeshjen dhe ta japim maksimumin për t'u inkuadruar në Superligë. Jemi munduar të përgatitemi maksimalisht për këtë ndeshje, pasi është ndeshja e vitit si për ne, po ashtu edhe për kundërshtarin. Për Vëllaznimin mendoj se ka një skuadër të mirë, që ka dëshmuar edhe në ndeshjet e Superligës", ka thënë Dautaj, i cili me këtë rast ka konfirmuar se skuadra e tij nuk e ka asnjë mungesë për këtë ndeshje.
